



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Teknik në
Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi”
Kolegji Universitar “REALD”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


- 1. Prof. As. Dafina Hyka**
- 2. Dr. Gjok Tosku**

MAJ / 2025


TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Bsc në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
Kolegji Universitar “REALD”

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “REALD”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 386, datë 08.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 PAE/ 2 PAK v.a. 2022-2023 14 PAE/ 7 PAK v.a. 2023-2024
18	Numri i studentëve:	4 Studentë v.a. 2022-2023 8 Studentë v.a. 2023-2024
19	Komente / të tjera:	-



2



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar “REALD” (KUR) është institucion jo publik i arsimit të lartë, licensuar me VKM Nr. 650, datë 14.09.2011, me statusin Kolegji Universitar. Struktura akademike e Kolegji Universitar “REALD”, aktualisht përbëhet nga dy njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore
2. Fakulteti i Ekonomisë

Programi i studimit Bachelor në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi” është hapur me UMAS Nr. 386, datë 08.07.2022 me formë studimi me kohë të plotë, 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike. Programi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Pas shqyrtimit të aktivitetit të zhvilluar në vitet e fundit, GVJ konstaton se Programi i Studimit Bachelor në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi” ka arritur rezultate të dukshme në përgatitjen e studentëve, duke i pajisur ata me aftësi teknike për të aplikuar njohuri të avancuara në fushën e imazherisë. Studentët zhvillojnë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur në ambientet spitalore, për të marrë përgjegjësi profesionale dhe etike, si dhe për të komunikuar në terma profesionalë. Po ashtu, ata janë të aftë të kërkojnë zgjidhje përmes konsultimeve me kolegët dhe literaturën profesionale, si dhe menaxhojnë me sukses sfida të ndryshme. Programi u ofron atyre njohuri të plota mbi standardet dhe metodologjitë bashkëkohore të fushës.

Në të gjitha takimet, veçanërisht ato me studentët, GVJ ka vërejtur se ky program ka synime të qarta dhe të matshme, duke siguruar që diplomuarit të jenë të kërkuar në tregun e punës, si në nivel vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Po ashtu, ky program mundëson që ata të realizojnë ambicie të guximshme për të vijuar studimet në ciklet më të larta, si Master apo Doktoratë. Në përfundim të këtij vlerësimi, GVJ ka konfirmuar se Programi i Studimit Bachelor në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi” është një program i suksesshëm që zhvillohet në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar dhe ofron një infrastrukturë mësimore që plotëson më së miri nevojat e studentëve, duke mbështetur përpjekjet dhe arritjet e stafit në mësimdhënie dhe punën kërkimore-shkencore. Programet e lëndëve dhe plani mësimor janë tashmë të orientuara drejt një oferte të thelluar dijesh që përgatit studentët për të vazhduar studimet dhe për t'u integruar me sukses në tregun e punës.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi” filloi me ngritjen e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ). ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga KUR, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. As. Dafina Hyka, dhe Dr. Gjok Tosku. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistuar dhe nga koordinatoi teknik i ASCAL, Z. Muhamed Prezja.

Grupi shqyrtoi dhe analizoi dosjen e vetvlerësimit, duke u fokusuar veçanërisht në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Ky proces i njohjes dhe studimit të dosjes solli formulimin e disa pyetjeve që lidhen me nevojën për sqarimin e gjetjeve të përfshira në RVB, plotësimin e informacioneve të nevojshme, konkretizimin e prezantimeve dhe rregullimin e vlerësimeve. Vizita në institucion u realizua me datat 12-13 Dhjetor 2024. Gjatë vizitës, GVJ realizoi takime me Dekanin e Fakultetit, Përgjegjësin e Departamentit të PS Bachelor në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi”, grupin e vetvlerësimit, personelin akademik, studentët, njësinë e sigurimit të cilësisë, si dhe përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Karrierës dhe sekretarisë mësimore. Përveç kësaj, GVJ vizitoi mjediset mësimore, ato sociale-kulturore dhe laboratorike, ku zhvillohet programi i studimit Bachelor në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi”. Gjatë këtyre takimeve, GVJ shqyrtoi nga afër nivelin e plotësimit të standardeve të kërkuara për programin, si dhe organizimin, drejtimin dhe administrimin e tij. U diskutua gjithashtu për proceset e mësimdhënies, mësimnxënies dhe zhvillimit të kompetencave, burimet financiare, infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për realizimin e programit, si dhe për trajtimin dhe mbështetjen e studentëve, si dhe aktivitetet për sigurimin e cilësisë.

Në përputhje me dokumentacionin bazë të sistemuar në dosjen e vetvlerësimit, informacionet e mbledhura, plotësimet dhe saktësimet e bëra, si dhe gjetjet konkrete, GVJ përgatiti të gjithë materialin e nevojshëm për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm (RVJ).

Në datë 30.04.2025 ASCAL dërgoi nëpërmjet sistemit draft raportin e punuar nga GVJ tek Kolegji Universitar “REALD”. Me datë 07.05.2025, KU REALD dërgoi komentet e tij në lidhje me përmbajtjen e këtij drafti, të cilat GVJ i konsiderojë me shumë vëmendje, por i qëndron mendimit të saj. GVJ e kupton punën e madhe të institucionit në drejtim të përmirësimit të programit të studimit dhe e nxit të vazhdojë më tej. Ky raport përfaqëson mendimin përfundimtar të GVJ-së në lidhje me këtë program studimi.



4



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësish kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Kolegji Universitar Reald ka si qëllim mbështetje të aspiratave arsimore dhe arritjeve të individëve, përgatitjen e specialistëve të kualifikuar në fushën e mjekësisë, arritjen e standardeve më të larta akademike dhe promovimin e zhvillimit kërkimor-shkencor. Ky institucion ofron programe studimi që janë në përputhje me interesat kombëtare dhe kërkesat e institucioneve politike në fushën e mjekësisë. Sipas statutit, programet e studimit të ofruara nga Kolegji Universitar Reald synojnë përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar në fushat përkatëse dhe janë të alignuara me misionin dhe objektivat e institucionit. Këto programe jo vetëm që përpiqen të ruajnë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare, por gjithashtu synojnë zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre. <i>(Evidence 3 – Strategjia e Zhvillimit Institucional)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	KUR ofron programe në disa nga fushat kryesore të shëndetit, duke synuar përgatitjen e specialistëve të shëndetësisë për të siguruar ofrimin e shërbimeve më cilësore ndaj pacientëve dhe për edukimin e tyre të vazhdueshëm, në përputhje me trendet e zhvillimit bashkëkohor. Programi Bsc në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi” ofron mundësi formimi për studentët në fushën e imazherisë dhe radioterapisë, duke i trajnuar ata për të luajtur një rol të rëndësishëm në kujdesin mjekësor. <i>(Evidence 2 – Statuti i KUR)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Sipas RVB-së, KUR ofron programe studimi që respektojnë tërësisht kuadrin ligjor të arsimit të lartë dhe nuk bien në kundërshtim me asnjë interes kombëtar. Studentët në KUR jo vetëm që zhvillojnë aftësi profesionale, por gjithashtu edukohen me ndjenjën e humanitetit dhe me vlerësimin e interesave kombëtare. Programet e studimit janë të orientuara në përputhje me interesat kombëtare dhe ato të institucioneve politike në fushën e mjekësisë. Duke u mbështetur në gjetjet e tij gjatë vizitës në institucion, GJV konstaton se Programi i Studimit Bachelor në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi” ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.



	GVJ ka shqyrtuar paraprakisht dokumentet bazë mbi të cilat zhvillohet aktiviteti në KUR dhe ka konstatuar se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. <i>(Evidence 2 – Statuti i KUR)</i> <i>(Evidence 3 – Strategjia e Zhvillimit Institucional)</i> <i>(Evidence 4 – Rregullore e Përgjithshme e KUR)</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	KUR ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit, çka tregon se tashmë se institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit të kapaciteteve infrastrukturore që disponon. Programi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Sipas evidencave shoqëruese të RVB Fakulteti i Shkencave Mjekësore për vitin akademik 2022-2023 ka të angazhuar në total 61 anëtar në personelin akademik. Nga të cilët 48 janë personel akademik me kohë të plotë nga ku 3 kanë titullin “Profesor”, 18 kanë gradën Doktor Shkencash dhe 27 janë në Asistent Lektorë me Msc. Gjithashtu personeli akademik me kontratë (PAK) konstiton në një total prej 12 anëtarësh, nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 6 kanë gradën Doktor Shkencash, 4 Asistent Lektorë me Msc. Ndërsa Departamenti i Shkencave Teknike mjekësore ka dhe 1 personel ndihmës akademik. Përsa i përket personelit akademik të angazhuar në programin e studimit në vitin akademik (2022-2023), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 14 pedagogë gjithsej, ku 12 PAE, nga të cilët 1 mban titullin Prof., 1 Prof.Asoc, 2 me gradën Doktor shkencash, 1 me SPA si edhe 7 asistente-lektore me Msc, dhe 2 PAK nga të cilët 1 me titullin Prof.Asoc dhe 1 me gradën Doktor Shkencash. Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2022-2023 si numër fizik rezulton 86% me 14%. Përsa i përket personelit akademik të angazhuar në programin e studimit në vitin akademik (2023-2024), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 21 pedagogë gjithsej, ku 14 PAE, nga të cilët 1 mban titullin Prof., 3 me gradën Doktor shkencash, 1 me SPA si edhe 7 asistente-lektore me Msc, dhe 7 PAK nga të cilët 2 me titullin Prof. Asoc, 4 me gradën Doktor shkencash, dhe 1 Dr (c). Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2023-2024 si numër fizik rezulton 67% me 33%.

	Rezulton se personel akademik me MSc është angazhuar edhe si titullar lënde, GVJ rekomandon rekrutim të personelit akademik me tituj. (Evidence – Tabelat Përmbledhëse) (Evidence 12 – Lista e Stafit Akademik të njësisë bazë) (Evidence 15 – Lista e auditorëve dhe ambienteve në funksion të procesit mësimor)			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Sipas statutit të institucionit, rregullores së universitetit, rregulloreve të fakulteteve, strategjisë së zhvillimit dhe programeve që ofrohen nga secili fakultet, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të KUR. Programi i studimit "Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi" ka të njëjtin profil si njësia kryesore. Institucioni zbatuan me saktësi çdo udhëzim dhe akt nënligjor të publikuar. Ky program është pajisur me kodin përkatës 63BA0914S sipas përcaktimeve në VKM Nr. 310 datë 11.05.2022 dhe në udhëzimin Nr. 31 datë 15.11.2022. Kodi i programit të studimit përbëhet nga fusha e gjerë, fusha e ngushtë dhe fusha e detajuar. (Evidence 2 - Statuti i KUR) (Evidence 4 – Rregullore e Përgjithshme e KUR) (Evidence 5 – Rregullore e FSHM) (Evidence 6 - Rregullore e programit të studimit)			
Konkluzione	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konkludon se Programi i Studimit i ofruar mbështetet dhe mbron vlerat kombëtare në mënyrë të plotë. Ky program është dizajnuar dhe implementuar në përputhje me parimet dhe nevojat e shoqërisë, duke promovuar zhvillimin e njohurive dhe aftësive që kontribuojnë në avancimin e vlerave kulturore, profesionale dhe etike të kombit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi	GVJ konstaton që KUR ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit duke siguruar një bashkëpunim funksionues. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore

brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	në koordinim të plotë më njësitë kryesore. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. <i>(Evidence 2- Statuti i KUR)</i> <i>(Evidence 4 – Rregullore e Përgjithshme e KUR)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe si dhe institucione të tjera që ndihmojnë në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve. Marrëdhëniet me institucione homologe mundësojnë shkëmbimin e përvojave dhe resurseve të përbashkëta, si dhe mundësojnë realizimin e projekteve kërkimore të përbashkëta që rrisin cilësinë akademike dhe përmirësojnë nivelin e mësimdhënies, vlen të përmenden marrëveshjet me universitetin “I. Qemali” në Vlorë, Albanian University dhe si Universiteti i Salernos. Po ashtu, partneritetet me aktorë të biznesit vendës ofrojnë mundësi për internship-e, praktika profesionale dhe projekte të aplikueshme në industri, që janë të rëndësishme për përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Gjithashtu, këto marrëdhënie ndihmojnë në përshtatjen e programit mësimor me kërkesat e zhvillimeve të fundit të tregut të punës, si dhe lejojnë studentët të përfitojnë njohuri dhe aftësi të nevojshme për të konkurruar në nivele ndërkombëtare. <i>(Evidence 39 – Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Salernos)</i> <i>(Evidence 39 – Marrëveshje bashkëpunimi me KUB)</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Gjatë shqyrtimit të DVV dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi që Kolegji Universitar Reald ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa spitale si: spitali rajonal i Fierit, Spitali Rajonal Vlorë, Spitali psikiatrik, spitali Memorial si dhe klinika dhe laboratore të ndryshme. <i>(Evidence – Tabelat përmbledhese, Tab. 5)</i> <i>(Evidence 36 – Lista e IAL me të cilat KUR ka Marrëveshje Bashkëpunimi)</i> <i>(Evidence 37 – Lista e subjekteve me të cilat KUR ka Marrëveshje Bashkëpunimi)</i> <i>(Evidence 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44 – Marrëveshje bashkëpunimi)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion	Njësia përgjegjëse për programin e studimit është e angazhuar në hartimin e raporteve analitike periodike, të cilat vlerësojnë përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe aktorë të tjerë, si dhe ndikimin e këtyre marrëveshjeve në zhvillimin e programit të studimit. Përgjatë procesit të hartimit të raporteve analitike, njësia

të realizimit të programit të studimit.	përgjegjëse siguron mbledhjen e të dhënave relevante, garantuar një analizë objektive të përfitimeve. <i>GVJ sugjeron që raportet analitike të përfshijnë gjithashtu rekomandime të qarta për përmirësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe implementimin e strategjive të reja, në mënyrë që bashkëpunimet të sjellin përfitime sa më të mëdha për studentët dhe zhvillimin e programit të studimit.</i> Këto raporte do të jenë një mjet i vlefshëm për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidence 45 – Raport lidhur me efikasitetin e bashkëpunimit)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konkludon se, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimit me institucionet spitalore dhe palë të treta të cilat janë thelbësore për realizimin e programit të studimit, duke ofruar mundësi praktike për studentët dhe ndihmojnë në zhvillimin e aftësive profesionale në kushte reale pune.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në "Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi" është i strukturuar në 3 vite akademike, organizuar në 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 24 lëndë me modulet përkatëse të ndara sipas 3 viteve shkollorë (8 lëndë në vitin e parë; 10 lëndë në vitin e dytë; dhe 8 lëndë në vitin e tretë). Në 26 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihet edhe punimi i diplomës, si edhe praktika mësimore. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi

9

	dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Kreditet ECTS për çdo disiplinë mësimore dhe aktivitet formues llogariten duke marrë parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që studentët duhet të kryejnë për të përmbushur të gjitha detyrimet e përcaktuara në programin e lëndës. Një kredit përkthehet në 25 orë pune të studentit, ku përfshihen orët e mësimdhënies në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekte/detyra dhe aktivitete të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orët e punës individuale të studentit. <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Bachelor në "Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi" ofron një përgatitje të plotë për studentët në fushën e teknologjive dhe teknikave radiologjike, duke përfshirë imazherinë mjekësore dhe radioterapinë. Studentët fitojnë njohuri dhe aftësi të avancuara për përdorimin e pajisjeve të sofistikuara dhe trajtimin e pacientëve, si dhe zhvillojnë shprehje për komunikim dhe bashkëpunim në një mjedis shëndetësor. Ky program gjithashtu i mundëson studentëve të vazhdojnë karrierën akademike dhe kërkimore, duke ofruar mundësi për avancim në pozita menaxheriale ose pozita të tjera në fushën e radiologjisë mjekësore. <i>Por, rekomandojmë që personeli akademik që është titullar syllabusi si dhe titullar lënde t'i përmbahet kategorisë së përcaktuar në aktet ligjore.</i> <i>(Evidence 16 – Programi i mësimi)</i> <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i> <i>(Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve)</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje: ▪ Kategoria A - 19% ▪ Kategoria B - 53% ▪ Kategoria C - 12% ▪ Kategoria D - 13% ▪ Kategoria E - 3% Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e	Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite të praktikave profesionale si dhe të detyrimeve përmbledhëse. Përkatësisht janë

praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	përcaktuar 16 kredite ECTS në total për praktikë profesionale. Specifikisht, 3 kredite praktikë profesionale në vitin e parë akademik, 5 kredite praktikë në vitin e dytë akademik, dhe 8 kredite në vitin e tretë akademik. Ky program studimi ka përcaktuar detyrimet përmbyllëse me 6 kredite për mbrojtjen e diplomës. <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i> <i>(Evidence – Tabelat përmbledhese, Tab. 9)</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Kolegji Universitar Reald është institucion jo publik i cili organizon dhe ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë. Pranimi i studentëve bëhet sipas ligjit në fuqi dhe akteve rregullatore të KUR, studentët e transferuar pranohen vetëm në vitet e ndërmjetme. <i>(Evidence 2 - Statuti i KUR)</i> <i>(Evidence 4 – Rregullore e Përgjithshme e KUR)</i> <i>(Evidence 6 – Rregullore e Programit të studimit)</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimi Bachelor në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi” ka përmbajtje të ngjashme të lëndëve në këtë nivel me programe të njëjta të së njëjtës fushë, duke përmendur këtu Universitetin e Salernos me të cilin institucioni ka edhe një marrëveshje bashkëpunimi si dhe me programe të ofruara në universitetin e Tiranës. <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar në udhëzimin 31 dt 15.12.2022, institucioni ka propozuar kodifikimin në MAS. Në sistemin e brendshëm të sekretarisë ka një kodifikim të programeve të studimit si dhe të lëndëve dhe moduleve përkatëse të këtij programi. Ky program studimi është pajisur me kodin 63BA0914S nga ekspertët. <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i> <i>(Vizita në sekretari)</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky Program Studimi ofrohet nga Kolegji Universitar REALD, dhe nuk është i përbashkët me asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë vendas apo të huaj.
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konkludon se, ky Program Studimi është zhvilluar në përputhje me ligjet</i>

	<i>dhe aktet ligjore në fuqi. Lëndët mësimore dhe ato të praktikës janë të ndara qartë dhe të organizuara në tre vitet akademike me një peshë të barabartë kreditesh. Por, rekomandojmë që personeli akademik që është titullar syllabusi si dhe titullar lënde t'i përmbahet kategorisë së përcaktuar në aktet ligjore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore është pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Fakulteti i Shkencave Mjekësore për vitin akademik 2022-2023 ka të angazhuar në total 61 anëtarë në personelin akademik. Nga të cilët 48 janë personel akademik me kohë të plotë nga ku 3 kanë titullin “Profesor”, 18 kanë gradën Doktor Shkencash dhe 27 janë në Asistent Lektorë me Msc. Gjithashtu personeli akademik me kontratë (PAK) konstiston në një total prej 12 anëtarësh, nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 6 kanë gradën Doktor Shkencash, 4 Asistent Lektorë me Msc. Ndërsa Departamenti i Shkencave Teknike mjekësore ka dhe 1 personel ndihmës akademik. Përsa i përket Departamentit, për vitin akademik 2022-2023 ka të angazhuar në total 21 anëtarë në personelin akademik. Nga të cilët 15 janë personel akademik me kohë të plotë nga ku 3 kanë gradën Doktor Shkencash dhe 12 janë në Asistent Lektorë me Msc (4SPA). Gjithashtu personeli akademik me kontratë (PAK) konstiston në një total prej 6 anëtarësh, nga ku 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 1 ka gradën Doktor Shkencash, 3 Asistent Lektorë me Msc. Për vitin akademik 2023-2024 ka të angazhuar në total 24 anëtarë në personelin akademik. Nga të cilët 14 janë personel akademik me kohë të plotë nga ku 3 kanë gradën Doktor Shkencash dhe 11 janë në Asistent Lektorë me Msc (4SPA). Gjithashtu personeli akademik me kontratë (PAK) konstiston në një total prej 10 anëtarësh, nga ku 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 3 ka gradën Doktor Shkencash, 4 Asistent Lektorë me Msc.

	Rezulton se personeli akademik me MSc. është angazhuar edhe si titullar lënde, GVJ rekomandon rekrutim të personelit akademik me tituj në mënyrë që të përmbushen kërkesat e akteve ligjore në fuqi. <i>(Tabelat permbledhese)</i>			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore ka angazhuar 1 personel ndihmës akademik i cili asiston në realizimin dhe ndjekjen e praktikave profesionale si në laboratorët e IAL ashtu edhe në kabinetet e ndryshme të imazherisë dhe radioterapisë në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit. Për ndjekjen dhe realizimin e praktikave profesionale angazhohet i gjithë personeli akademik i angazhuar në programin e studimit. <i>(Tabelat permbledhese)</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit, ka angazhuar një koordinator i cili është përgjegjës për ecurinë e programit të studimit Bachelor në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi” dhe angazhohet në ndjekjen dhe Koordinatori i programit të studimit është gjithashtu përgjegjës në orientimin e studentëve, informimin mbi rregulloren e Programit të Studimit, monitoron procesin mësimor si dhe adreson problematikat e ndryshme që lindin gjatë procesit mësimor. <i>(Evidence 46 – Vendim për caktimin e koordinatorit të programit të studimit)</i> <i>(Evidence 47 – Detyrat e koordinatorit të programit)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se Njësia Kryesore dhe ajo Bazë përgjegjëse për programin e studimit, ka angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore dhe caktimin e koordinatorit të programit. Por, institucioni ka angazhuar edhe personel akademik me MSc. si titullar lëndësh, GVJ rekomandon rekrutim të personelit akademik me tituj në mënyrë që të përmbushen kërkesat e akteve ligjore në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht X	Përmbushet plotësisht

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Referuar dosjes së vetëvlerësimit, vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti zotëron të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e programit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. <i>(Evidence 2 - Statuti i KUR)</i> <i>(Evidence 4 – Rregullore e Përgjithshme e KUR)</i> <i>(Evidence 6 – Rregullore e Programit të studimit)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Referuar planit mësimor për këtë Program Studimi, konstatohet se plani mësimor është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018. Programi i studimit “Teknik imazherie dhe radioterapi” është organizuar në tre vite akademike me 6 semestra. Programi i studimit Bachelor në "Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi" është i strukturuar në 3 vite akademike, organizuar në 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 24 lëndë me modulet përkatëse të ndara sipas 3 viteve shkollore (8 lëndë në vitin e parë; 10 lëndë në vitin e dytë; dhe 8 lëndë në vitin e tretë). Në 26 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihet edhe punimi i diplomës, si edhe praktika mësimore. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje: - Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): 33.5 ECTS (19%) - Kategoria B (lëndë të formimit karakterizues): 95.5 ECTS (53%) - Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): 21 ECTS (12%) - Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 24 ECTS (13 %) - Kategoria E (detyrimet përmbyllëse/mbrojtja e temës së diplomës): 6 ECTS (3%) <i>(Tabelat permbledhese)</i> <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit,	Programi i studimit përmban gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e pranimit në Programin e Studimit, metodologjinë e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. <i>(Evidence 6 – Rregullore e Programit të studimit)</i>

transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.				
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit, GVJ vlerësoi se ai përmban informacion të detajuar mbi ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë tij. Po ashtu, në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve, ofrohet informacion i plotë për frekuentimin e programit, ndjekjen e tij dhe metodat e vlerësimit të dijeve. Konkretisht në përgjithësi mënyra e vlerësimit të lëndës është si më poshtë: Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive – 5% Plotësimi i detyrimeve (laborator/detyra kursi) – 5% Testime gjatë vitit – 30% Provimi Përfundimtar – 60% (Evidence 6 – Rregullore e Programit të studimit) (Evidence 16 – Programi i mësimi) (Evidence 17 – Plani mësimor) (Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve) (Tabelat përmbledhese, tab. 12)			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Programi i studimit nuk ka pasur ndryshime përgjatë këtyre viteve pasi edhe nuk është mbyllur akoma një cikël i plotë studimi. Megjithatë përpjekjet e stafit akademik për përmirësimin e syllabuseve vit pas viti kërkohet punë me kompetencë edhe për përmirësimin e programit studimor. (Evidence 16 – Programi i mësimi) (Evidence 17 – Plani mësimor) (Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve)			
Konkluzione	GVJ konstaton se plani mësimor është i strukturuar në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, duke përfshirë ndarjen e kategorive, përshkrimin e detajuar të syllabusit, si dhe organizimin e praktikave dhe komponentëve të tjerë të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e KKURifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të KKURifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimet e moduleve/lëndëve, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikat profesionale ofrojnë mundësi për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të studentëve për tregun e punës. Gjatë vitit të parë, studentët ndoqin kryesisht lëndë bazë të formimit të përgjithshëm, ndërsa në dy vitet e tjera akademike, programi i studimit parashikon lëndë me formim specifik profesional, duke kontribuar në rritjen e kompetencave të studentëve. Personeli akademik i angazhuar duhet të përmbushë kriteret ligjore në fuqi. <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i> <i>(Tabelat përmbledhese)</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi ofron mundësi të shumta informacioni, duke përfshirë nocione bazë dhe të thelluara profesionale. Pas përvetësimit të njohurive themelore, studenti vazhdon të zhvillojë aftësitë e tij profesionale përmes lëndëve më të avancuara, duke përfshirë Radiologjinë konvencionale dhe më pas kalon në lëndë të tilla si CT, MRI dhe Mjekësinë nukleare. Gjithashtu, studenti merr njohuri të plota për Radioterapinë, një komponent kyç në ofrimin e kujdesit shëndetësor. Të gjitha këto njohuri i mundësojnë studentit të ofrojë shërbime profesionale në institucione shëndetësore dhe në kabinetet e radiologjisë të çdo qendre shëndetësore që disponon këto teknologji. Nga ana tjetër, shpërndarja e lëndëve në vite dhe semestra, së bashku me vlerësimin në kredite dhe orë mësimore, siguron realizimin e objektivave formuese të programit dhe arritjen e rezultateve të pritshme në aftësimin profesional të studentëve. <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i> <i>(Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve)</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i> <i>(Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve)</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Plani mësimor i programit të studimit parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Programi i studimit ka të përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike profesionale. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuri praktike në tema të ndryshme imazherike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një institucion shëndetësor, GVJ sugjeron rritjen dhe efikasitetin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

	<i>Pjesëmarrja e studentëve në praktika të organizuara nga Universiteti, në bashkëpunim me institucione që ofrojnë shërbime imazherike, lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit. GVJ rekomandon hartimin e një raporti të detajuar mbi efikasitetin që sjellin këto bashkëpunime në punësimin e studentëve.</i> <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i> <i>(Evidence – Tabelat permbledhese, Tab. 5)</i> <i>(Evidence 37 – Lista e subjekteve me të cilat KUR ka Marrëveshje Bashkëpunimi)</i> <i>(Evidence 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44 – Marrëveshje bashkëpunimi)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset e lëndëve përditësohen rregullisht, por jo gjithmonë me literaturë të publikuar brenda pesë viteve të fundit. Literatura në gjuhën shqipe për këtë program ka disa probleme, kryesisht për shkak të mungesës së teksteve në këtë gjuhë. Pjesa më e madhe e literaturës referuese është në gjuhë të huaja. <i>GVJ sugjeron përditësim të literaturës së detyruar dhe asaj të rekomanduar me botimet e fundit.</i> <i>(Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve)</i> <i>(Evidence 51, 52, 53 - Lista e literaturës në bibliotekë)</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësi praktikë të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale. <i>(Evidence 16 – Programi i studimit)</i> <i>(Evidence 17 – Plani mësimor)</i> <i>(Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve)</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Përmbajtja e programit të studimit i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë, të cilat janë të përshtatshme për nivelin e ciklit të parë të studimeve. Ky program krijon bazat e nevojshme për një studim më të thelluar dhe të avancuar në ciklin e dytë, master. Lëndët e zhvilluara dhe programet e tyre janë të strukturuar në mënyrë që të sigurojnë një përgatitje shkencore solide, duke mundësuar vijimin e mëtejshëm të studimeve, në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. <i>(Evidence 16 – Programi i studimit)</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit janë në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit, rezultatet e të nxënësve, mundësitë për vijimin e studimeve dhe kompetencat, duke u përputhur gjithashtu me kërkesat e tregut të punës. Sugjerojmë përditësim të literaturës në syllabuset e lëndëve.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Përmbajtja e programit të studimit i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Në hartimin e kurrikulës, institucioni ka përfshirë edhe specialistë të fushën për kryerjen e një studimi tregu me qëllim ofrimin e programeve të studimit sipas nevojave të tregut. Praktikat profesionale të përfshira në kurrikulën e programit, si dhe marrëveshjet e lidhura në nivel institucional me institucione të fushës së studimit, i jep mundësi studentëve të përgatiten për tregun e punës. <i>GVJ sugjeron një përmirësim të infrastrukturës së brendshme të institucionit me qëllim përmbushjen e orëve të praktikës të parashikuara në kurrikul.</i> Departamenti, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët shëndetësor dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut. <i>(Evidence 16 – Programi i studimit)</i> <i>(Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve)</i> <i>(Evidence 25 – Studim i tregut të punës)</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët janë të angazhuar në senat akademik, në NjSBC dhe në disa komisione të tjera në përputhje me aktet ligjore dhe për pasojë janë zë të studentëve dhe pjesë e vendimarrjes. Gjithashtu, Zyra e këshillimit dhe karrierës mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar Alumni në mënyrë që të marrin sugjerime në funksion të rishikimit të programit. Për këtë program studimi, nuk ka ende të diplomuar. <i>(Evidence 4 – Rregullore e Përgjithshme e KUR)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në	Njësia përgjegjëse e programit të studimit e përmirëson, përditëson dhe përshtat programin në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme, duke bashkëpunuar ngushtë me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (sidomos në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. Ky program studimi nuk

fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	ka kaluar në rishikim kurrikule duke qenë se nuk është akredituar akoma.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se studentët janë të përfshirë në disa komisione që mbështesin aktet ligjore dhe se ka një bashkëpunim të ngushtë me institucione universitare dhe organizata të ndryshme për të përmirësuar dhe integruar risitë në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Kolegji Universitar Reald përdor forma të ndryshme mësimdhënie që përfshijnë leksionet, seminarët, detyrat e kursit, projektet, laboratorët etj. Vihet re ndërthurje e teorisë me praktikën apo laboratorët në pjesën më të madhe të moduleve dhe lëndëve të këtij programi studimi. <i>GVJ sugjeron përmirësim të infrastrukturës për realizimin e laboratorëve mësimorë, për realizimin e projekteve në grup të studentëve etj.</i> (Evidence 16 – Programi i studimit) (Evidence 18 – Syllabusët e lëndëve) (Vizita e GVJ)
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Gjatë vizitës së GVJ në KUR, personeli akademik i pranishëm konfirmoi diversitetin e metodave të shpërndarjes së informacionit. Leksionet ofroheshin për studentët në forma të ndryshme, duke përfshirë paraqitje kompjuterike në klasë, shkarkimin e materialeve në version elektronik, video etj. Personeli akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie, të cilat përshtateshin sipas modulit, tematikës ose nevojave të studentëve.

	<i>(Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve)</i> <i>(Vizita e GVJ)</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Personeli akademik konfirmoi mbështetjen e plotë nga institucioni në përmirësimin e aftësive didaktike të tyre. Gjithashtu KUR nxit personelin akademik në përmirësimin e aftësive didaktike me anë të projekteve Erasmus + apo projekte të tjera bashkëpunimi me Universitetet partnerre europiane. <i>(Vizita GVJ, Të dhënat mbi mobilitetin)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentit mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Vihet re një rritje e Personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi. Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit nuk është në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi. Referuar tabelës 4.1 dhe 4.2, një numër i lartë lëndësh udhëhiqen nga titullar me titull MSc. <i>(Tabelat përmbledhese, tab. 12)</i> <i>(Evidence 13 – Lista e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit)</i> <i>(Evidence 14 – Të dhëna mbi stafin akademik të programit të studimit në tre vitet e fundit)</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Njësia kryesore vlerëson format e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme. Studentët shprehen se shumë prej sygjërimeve të tyre janë marrë në konsideratë gjatë procesit të mësimdhënies. Njësia kryesore realizon pyetësorë të përvitshëm të fokusuar në metodologjinë e mësimdhënies. <i>(Evidenca 56 – Raport vjetor i NJSBC)</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni ka krijuar struktura dhe njësi të dedikuara për të promovuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe për të koordinuar aktivitetet që lidhen me cilësinë e saj. Stafi akademik, siç u konfirmua gjatë vizitës së GVJ në KUR, përdor metoda mësimdhënieje të ndryshme dhe të adaptuara për çdo modul dhe tematikë, duke siguruar që mësimi të jetë i përshtatshëm dhe i efektshëm për studentët. Këto struktura dhe njësi mbështesin implementimin e metodave të reja dhe inovative, duke inkurajuar eksperimentimin dhe zhvillimin e teknologjive të reja në mësimdhënie.

Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Përveç kësaj, njësite e ngarkuara me përgjegjësi për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies ofrojnë trajnime të vazhdueshme për personelin akademik si dhe raporte vjetore me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>(Evidenca 65 Raport vjetor i IAL)</i> <i>(Evidenca 58 – Plan pune NJSBC)</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se Institucioni siguron një proces të efektshëm të të nxënit dhe aftësimit profesional dhe shkencor, duke përdorur metoda dhe praktikt me në qendër studentin. Institucioni është në përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin e aftësive të personelit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se institucioni ka përcaktuar dhe sanksionuar mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në përputhje me rregulloret përkatëse, të cilat janë të qarta dhe të njohura nga studentët. Universiteti siguron informimin e studentëve për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Këto rregullore janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të institucionit, ndërsa komunikimi i tyre përmes platformave online garanton informimin e plotë dhe të vazhdueshëm të studentëve. <i>(Evidenca 4 - Rregullore e përgjithshme e KUR)</i> <i>(Edivenca 6 – Rregullore e programit te studimit)</i> <i>(Evidenca 26 – Rregullore per zhvillimin e provimeve)</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik gjatë vizitës në institucion, u konstatua se stafi akademik, në javën e parë të semestrit, informon studentët mbi programin e lëndës. Ky program përmban informacione të detajuara, përfshirë: përmbajtjen e lëndës të organizuar javë pas javë, objektivat, rezultatet e pritura të të nxënit, materialet shtesë të lëndës, metodën e vlerësimit, shpërndarjen e ngarkesës dhe të tjera. <i>(Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve)</i>

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet në mënyra të ndryshme. Përgjatë zhvillimit të lëndës bëhen seminare, miniteste projekte, për vlerësimin e njohurive të studentit. Këto janë përshtatur në varësi të strukturës së modulit. <i>(Evidenca 4 - Rregullore e pergjithshme)</i>			
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë aplikon praktikën e realizimit të pyetsorëve për personelin akademik nga studentët me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Po ashtu koordinatori i programit të studimit është në kontakt të vazhdueshëm me studentët dhe stafin akademik me qëllim reflektimin e problematikave të studentëve në stafin akademik. <i>(Evidenca 56 – Raporti vjetor NJSBC)</i> <i>(Evidenca 61 – Pyetesor NJSBC per studentet)</i>			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	KUR mundëson përdorimin dhe alternimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies në përputhje me rezultatet e pristshme të syllabuseve të ndryshme. Ata nxisin dhe autonominë e studentit nëpërmjet laboratorëve, praktikave apo projekteve të caktuara në grup apo individualisht. Për vetë specifikën e disa moduleve, bashkëpunimi lektor –student është më I ngushtë duke i bërë studentët më konfident dhe më kërkues. <i>(Evidenca 18 - Syllabuset e lendeve)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se Institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të qarta për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, duke siguruar zbatimin e tyre të plotë dhe të rregullt.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të programit të studimit, konstatohet se testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve realizohet gjatë gjithë semestrit akademik. Janë përcaktuar dy periudha kohore për provimet përfundimtare. Provimet ndërmjetëse dhe vlerësimi i vazhdueshëm kryhen gjatë semestrit, përmes minitesteve, projekteve dhe detyrave të kursit, sipas syllabusit përkatës. Në përgjithësi, 30% e vlerësimit përfundimtar të studentëve vjen nga vlerësimi i vazhdueshëm, ndërsa 70% nga provimi përfundimtar. Programi i studimit ka një profil të theksuar profesional, dhe vlerësimi i studentëve përfshin jo vetëm njohuritë, por edhe aftësitë profesionale. <i>(Evidenca 4 - Rregullore e përgjithshme)</i> <i>(Evidenca 18 - Syllabuset e lendeve)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimet dhe provimet e parashikuara për lëndët/modulet e programit të studimit zhvillohen në përputhje me përcaktimin në syllabuse, e cila i bëhet e ditur studentit që në orën e parë të mësimi. Rezultatet përfundimtare të provimit përditësohen në platformën online. KUR ka hartuar edhe platformën e provimeve online, rregullore që i është bërë e qartë edhe studentëve që në fillim të vitit akademik. Rregulloret e Institucionit janë të pasqyruara në faqen e internetit. <i>(Evidenca 18 - Syllabuset e lendeve)</i> <i>(Evidenca 26 – Rregullore për zhvillimin e provimeve)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Referuar rregullores së programit si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga pedagogu i lëndës ose nga komisioni i pedagogëve në varësi të lëndës specifike. Detyrat, prezantimet në klasë, projektet, raste studimore, etj, vlerësohen nga pedagogu i lëndës. <i>(Rregullore programi studimi)</i> <i>(Evidenca 26 – Rregullore për zhvillimin e provimeve)</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimi i zhvilluar me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit, rezultoi se në fletën e provimit pasqyrohen pikët e grumbulluara si dhe komentet përkatëse për gabimet e bëra. Komentet i përcohen edhe studentit duke dhënë edhe sugjerime me qëllim përmirësimin. <i>(Evidenca 68 – Model testi)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti, nëpërmjet rregulloreve të hartuara, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Studenti penalizohet nëse vihen re raste të kopjimit apo të plagjiaturës gjatë realizimit të detyrimeve akademike të tij. <i>(Evidenca 26 – Rregullore për zhvillimin e provimeve)</i>

Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Afatet për përfundimin e vlerësimit janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura në kalendarin akademik të universitetit. Notat përfundimtare finalizohen brenda 3 ditëve pas përfundimit të periudhës së provimeve. (Evidenca 4 - Rregullore e përgjithshme)			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studentëve u jepet e drejta të ankimojnë rezultatet e tyre, duke paraqitur një kërkesë me shkrim pranë Departamentit përkatës. Departamenti krijon një komision të posaçëm, i cili rivlerëson tezën në prani të studentit dhe pedagogut të lëndës. I gjithë ky proces dokumentohet në departament. (Evidenca 4 - Rregullore e përgjithshme) (Evidenca 26 – Rregullore për zhvillimin e provimeve)			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni angazhohet plotësisht në zbatimin e rregulloreve të fakultetit lidhur me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të studentëve, duke mbështetur vlerësimin bazuar në meritokraci.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ konstaton se përbërja e planit mësimor dhe zhvillimi i lëndëve garantojnë mundësinë për thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Programi i studimit i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë, duke siguruar që niveli i njohurive të jetë në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve. Përveç njohurive shkencore teorike, programi synon gjithashtu aftësimin praktik të studentëve përmes laboratorëve dhe praktikave. <i>GVJ sugjeron përmirësimin e kushteve të laboratorëve me qëllim që të mundësohet një realizim më efikas i praktikave mësimore, duke</i>

	<i>kontribuar kështu në zhvillimin më të plotë të aftësive praktike të studentëve.</i> <i>(Evidenca 16 – Programi i studimit)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Referuar planit mësimor 13% e kurrikulës është e përbërë nga lëndë të kategorisë D, që garantojnë zhvillimin e aftësive të vecanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit, dhe ndërveprimit si Informatikë, Informatikë e Aplikuar, Gjuhë Angleze, etj. <i>(Evidenca 16 – Programi i studimit)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të vitit akademik përmbledhen, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti sipas syllabuseve të çdo lënde. Bazuar në këto informacione të mbledhura, pedagogu i lëndës rishikon çdo vit syllabusin dhe nisur nga analiza e zhvillimit të mësimin, sygjeron ndryshime me synim përmirësimin e pritshmërive nga studentët. <i>GVJ rekomandon përditësimin e syllabusit me literaturë të 5 viteve të fundit, duke ju përmbyllur akteve rregullatore në fuqi.</i> <i>(Evidenca 18 - Syllabuset e lendeve)</i> <i>(Evidenca 31 – Analize e Departamentit)</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucionin ka bërë përpjekje të dukshme për të realizuar mësimdhënie mbi bazë kompetencash, duke ofruar mundësi për studentët për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorë dhe nëpërmjet praktikave profesionale. Personeli akademik mbështet aktivisht diskutimet dhe punën në grup, duke i ndihmuar studentët në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve të caktuara. Gjithashtu, ai krijon një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore dhe shkencore, dhe i mbështet ato në mënyrë aktive. <i>Pavarësisht këtyre përpjekjeve, zhvillimi i njohurive të marra në laboratorë kërkon ende përmirësime për të siguruar që studentët të kenë mundësinë për të aplikuar njohuritë teorike në kushte reale dhe për të zhvilluar aftësitë praktike në mënyrë më efektive. Ky hap është thelbësor për të garantuar një lidhje më të ngushtë mes mësimdhënies dhe praktikës profesionale.</i> <i>(Vizita ne Institucion)</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë,	GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar, realizon orë të hapura dhe seminare për të diskutuar zhvillime të reja të shkencës dhe

realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	teknologjisë, brenda ose jashtë strukturës së programit të studimit. <i>Megjithatë, për të përmirësuar më tej cilësinë dhe efektivitetin e procesit mësimor, sugjerohet rritja e numrit të orëve të hapura dhe seminareve akademike.</i> Këto aktivitete mund të ofrojnë mundësi më të shumta për studentët dhe personelin akademik për të diskutuar risitë shkencore dhe teknologjike, duke i mbajtur ata të përditësuar dhe të angazhuar në kërkime të avancuara. <i>Gjithashtu, është e rëndësishme të rriten mundësitë e trajnimeve për personelin akademik, për t'u mundësuar atyre zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale dhe për t'i ndihmuar të jenë në hap me ndryshimet e shpejta në fushat e shkencës dhe teknologjisë.</i> Kjo do të kontribuonte në përmirësimin e mësimdhënies dhe ofrimit të mundësive më të mira për studentët. <i>(Evidenca 67 – Leksion i hapur)</i> <i>(Vizita ne Institucion)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni është i angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, të cilat realizohen mbi bazë kompetencash të qarta dhe të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Pavarësisht përpjekjeve të institucioni për të ofruar mundësi zhvillimi për studentët, është e nevojshme të rriten mundësitë për orë të hapura, seminare akademike dhe trajnime për personelin akademik, për të siguruar një lidhje më të fortë mes mësimdhënies dhe praktikës profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar në DVV dhe informacioni i marrë nga takimi me studentët, GVJ konstaton se institucioni ka një procedurë të veçantë për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, e cila është e përcaktuar në rregulloren e institucionit. <i>(Evidenca 27 - Rregullore e diplomimit)</i>

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Gjatë takimit të zhvilluar me studentët, vihet re se informacioni dhe udhëzimet për provimin final janë vënë në dispozicion të studentëve. Në raste të caktuara pedagogët janë të disponueshëm për ofrimin e konsultimeve për studentët gjatë procesit të përgatitjes së tyre për provimin përfundimtar. <i>GVJ sugjeron përditësim të faqes Eëb të institucionit duke publikuar të të gjitha aktet rregullatore, me qëllim aksesin nga studentët.</i> <i>(Evidenca 27 - Rregullore e diplomimit)</i> <i>(Evidenca 30 – Udhezim per punimin e diplomes)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i përgjithshëm përfundimtar është i përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve të tyre bachelor. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre ECTS në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i Departamentit përgatit provimin e përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar. <i>(Evidenca 27 - Rregullore e diplomimit)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Pedagogët përgjegjës për punimet e diplomës përgatisin dhe shpërndajnë një program të detajuar për provimin e diplomimit në fillim të semestrit. Ata orientojnë dhe asistojnë studentët në përzgjedhjen e temave të punimit të diplomës, duke i udhëzuar ata në procesin e përpunimit të rezultateve dhe hartimit të punimit sipas udhëzuesve të miratuar. Pedagogët punojnë ngushtë me studentët në mënyrë të pavarur, duke ndarë me ta materialet e nevojshme që i ndihmojnë ata në përgatitjen për provimin përfundimtar. Ata gjithashtu garantojnë cilësinë e rezultateve të punimeve dhe miratojnë ose jo, nëse punimi është i plotë dhe i gatshëm për t'u paraqitur para komisionit. <i>(Evidenca 27 - Rregullore e brendshme)</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Universiteti i jep mundësinë studentin të përdorë infrastrukturën e institucionit, librarine, si dhe suportin nga personeli akademik. <i>GVJ sugjeron angazhim të stafit ndihmës akademik të kualifikuar për t'i mbështetur studentët gjatë procesit të përgatitjes për provimin përfundimtar si dhe orëve laboratorike.</i> <i>(Evidenca 27 - Rregullore e diplomimit)</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi përfundimtar vlerësohet me notë, nga komisioni përgjegjës për koordinimin e provimin të diplomës. <i>(Evidenca 27 - Rregullore e diplomimit)</i>

Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, pasi studenti përmbush të gjitha detyrimet akademike, duke përfshirë dhe mbledhjen e 180 ECTS, sekretaria mësimore përfundon procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me Diplomën përkatëse si dhe me Suplementin e Diplomës të aprovuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. <i>(Evidenca 71 – Modeli i Diplomes)</i> <i>(Evidenca 73 – Modeli i suplementit te Diplomes)</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Referuar RVB-së, KUR ruan kopje të dokumentacionit të studentëve në arkivën e saj elektronike dhe fizike dhe, për çdo rast individual, lëshon vërtetime në përputhje me kërkesat specifike të studentëve. Këto vërtetime mund të jenë për qëllime të ndryshme, siç janë kërkesat për praktika profesionale, aplikime për punësim, transferime apo dokumente të tjera administrative. <i>(Evidenca 74 – Database per ruajtjen e te dhenave)</i>			
Konkluzione	GVJ sugjeron angazhim të stafit ndihmës akademik të kualifikuar për t'i mbështetur studentët gjatë procesit të përgatitjes për provimin përfundimtar si dhe orëve laboratorike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kKURifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e	Nga dokumentacioni i paraqitur vihet re një rritje e numrit të personelit akademik gjatë viteve, duke kontribuar kështu në forcimin e stafit dhe mbulimin e kërkesave të programit të studimit. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i lëndëve janë mbuluar nga personel akademik me titull MSc, duke mos plotësuar kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit akademik.

programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Përsa i përket personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, për vitin akademik 2022-2023 ka të angazhuar në total 14 anëtarë në personelin akademik. Nga të cilët 12 janë personel akademik me kohë të plotë nga ku 1 ka titullin “Prof. Dr.”, 1 ka titullin “Profesorë i Asociuar”, 2 kanë gradën Doktor Shkencash dhe 8 janë në Asistent Lektorë me Msc (1 SPA). Gjithashtu personeli akademik me kontratë (PAK) konstiston në një total prej 2 anëtarësh, nga ku 1 ka titullin “Profesorë të Asociuar” dhe 1 ka gradën Doktor Shkencash. Përsa i përket personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, për vitin akademik 2023-2024 ka të angazhuar në total 21 anëtarë në personelin akademik. Nga të cilët 14 janë personel akademik me kohë të plotë nga ku 1 ka titullin “Prof. Dr.”, 3 kanë gradën Doktor Shkencash dhe 10 janë në Asistent Lektorë me Msc (3 SPA). Gjithashtu personeli akademik me kontratë (PAK) konstiston në një total prej 7 anëtarësh, nga ku 2 ka titullin “Profesorë të Asociuar”, 4 kanë gradën Doktor Shkencash, 1 Asistent Lektorë me Msc. <i>Ky faktor kërkon vëmendje dhe përmirësim, për të siguruar që të gjitha lëndët dhe modulet e programit të drejtohen dhe mbulohen nga staf akademik që plotëson kërkesat ligjore dhe profesionale të përcaktuara.</i> <i>(CV e Personelit Akademik)</i> <i>(Tabelat Permbledhese)</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i planeve të ngarkesës akademike për çdo pedagog, u konstatua se personeli akademik efektiv mbulon shumicën e lëndëve dhe modulet e programit të studimit në përputhje me kërkesat ligjore. Numri i pedagogëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm është i organizuar në mënyrë të tillë që të sigurohet realizimi i plotë i ngarkesës akademike, duke respektuar standardet e përcaktuara nga ligji për arsimin e lartë. Përveç angazhimit në procesin mësimor, pedagogët janë të përfshirë në veprimtari të tjera akademike, si mbikëqyrja e praktikave profesionale, mentorimi i studentëve dhe pjesëmarrja në projekte kërkimore. <i>GVJ sugjeron një ulje të ngarkesës mësimore në mënyrë që personeli akademik të ketë hapësirën e nevojshme për t’u përfshirë në angazhime kërkimore-shkencore.</i> <i>(Tabelat Permbledhese)</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit,	Gjatë vlerësimit, u shqyrtuan kontratat e punës ndërmjet universitetit dhe stafit akademik. U konstatua se të gjithë pedagogët aktivë kanë kontrata të formalizuara pune, të cilat përcaktojnë qartë detyrimet dhe të drejtat e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kontratat janë të vlefshme për periudha të përshtatshme kohore, duke siguruar kështu vazhdimësinë e procesit akademik.

duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Po ashtu, institucionin ka siguruar mbulimin e personelit akademik efektiv me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Dokumentacioni financiar dhe administrativ tregon se të gjithë punonjësit janë të regjistruar në skemat përkatëse të sigurimeve, duke respektuar standardet ligjore për punësimin në arsimin e lartë. <i>(Evidenca 24 – Model kontrate pune)</i> <i>(Evidence – Tabelat Përmbledhëse)</i> <i>(Evidence 12 – Lista e Stafit Akademik të njësisë bazë)</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga takimi me njësitë përgjegjëse, dokumentacioni shoqëruar I RVB, vihet re se institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, të cilat mbështeten në kritere që synojnë të garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. <i>(Evidenca 76 - Praktike rekrutimi e stafit akademik)</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Duke marrë parasysh natyrën specifike dhe kërkesat e programit të studimit në Bachelor në “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi”, është e nevojshme të rritet numri i personelit ndihmës akademik. Kjo do të mundësojë një mbështetje më të plotë për orët laboratorike dhe përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve praktike, duke u siguruar që çdo student të ketë mundësinë të ketë një asistencë të mjaftueshme dhe të specializuar. Kjo rritje e stafit ndihmës akademik do të ndihmojë gjithashtu në mbajtjen dhe përditësimin e pajisjeve dhe teknologjisë në përputhje me kërkesat e programit të studimit dhe zhvillimet e fundit në fushën e radiologjisë mjekësore dhe terapisë me rrezatime. <i>(Tabelat përmbledhëse)</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të	Referuar rregullores së institucionit dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar KUR, mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe ato të personelit ndihmës dhe administrativ. Ruajtja dhe përditësimi i këtyre të dhënave realizohet në dosjet përkatëse të personelit. Gjatë shqyrtimit të dosjeve nga GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore, u vërejt se ato përmbanin të gjitha të dhënat e kërkuara dhe ishin të përditësuara.

përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	(Evidence 14 – Te dhena mbi stafin akademik te programit te studimit ne tre vitet e fundit)
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Referuar evidencave të depozituara dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se institucioni ka zhvilluar marrëveshje dhe bashkëpunime me institucione që lidhen me fushën e studimit, përfaqësues biznesi dhe kompani të ndryshme, për të siguruar mbështetje dhe kualifikim për personelin e përfshirë në udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës profesionale dhe aktiviteteve të tjera të programit të studimit. <i>Sugjerohet një rritje e stafit ndihmës akademik të kualifikuar për të mbështetur studentët në përmbushjen e kërkesave të praktikës dhe aktiviteteve të tjera.</i> (Evidence 37, 37 – Lista e Marrëveshjeve te bashkëpunimit)
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Gjatë vizitës në institucion dhe në përputhje me aktet rregullatore të universitetit, GVJ ka konstatuar se personeli mbikëqyrës i angazhuar në realizimin e praktikave profesionale, në kuadër të marrëveshjeve të arritura me institucionet dhe kompanitë partnere, ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët në përmbushjen e detyrimeve të praktikës. Ky personel siguron udhëzim dhe ndihmë të vazhdueshme për studentët gjatë periudhës së praktikës, duke u mundësuar atyre të përmbushin standardet e kërkuara dhe të realizojnë detyrimet e përcaktuara nga programi i studimit. (Evidence 5 - Rregullore e FSHM) (Evidence 6 - Rregullore e Programit te studimit)
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni është i angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies. Po ashtu, institucioni ka zhvilluar procedura të strukturuar dhe të qarta për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave personale të personelit akademik dhe atij ndihmës, në përputhje me rregulloret përkatëse. Në lidhje me praktikat profesionale, institucioni ka siguruar angazhimin e personelit mbikëqyrës të kualifikuar, të cilët ofrojnë mbështetje të vazhdueshme dhe realizojnë një proces të ngushtë vlerësimi dhe mbikëqyrjeje për studentët. Megjithatë, për të përmirësuar më tej cilësinë e mbështetjes gjatë periudhës praktike, është e nevojshme një angazhim më i lartë i personelit ndihmës akademik.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në RVB dhe evidencat e ngarkuara, si dhe vizitën në institucion, rezultojnë se KUR siguron ambiente të bollshme dhe shumë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, duke marrë parasysh numrin e studentëve dhe specifikën e programit të studimit. Auditoret, laboratorët dhe mjediset ndërmjetëse janë të gjitha funksionale, dhe institucioni disponon një kampus modern me hapësira të dedikuara për një proces akademik me standarde të larta logjistike. Megjithatë, për të rritur më tej cilësinë e mësimdhënies praktike dhe laboratorike, është e nevojshme një përmirësim i laboratorëve, duke siguruar pajisje dhe teknologji më të avancuara për të mbështetur zhvillimin e aftësive praktike të studentëve dhe për të përmirësuar rezultatet e mësimdhënies në këtë aspekt. <i>(Evidence 48 – Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit)</i> <i>(Vizita në institucion, turi i ambienteve)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në të gjitha ambientet mësimore të institucionit, të cilat u vizituan nga GVJ, u vërejtën pajisje moderne si tabela interaktive, projektorë video, kompjuterë dhe akses në internet, të cilat ishin funksionale dhe në gjendje të mirë. Laboratorët ishin të pajisur me pajisjet përkatëse për të mbështetur zhvillimin e procesit mësimor, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Megjithatë, do të ishte e nevojshme që këto laboratorë të përmirësohen më tej, duke investuar në teknologji më të avancuara dhe pajisje shtesë për të siguruar një mjedis më efikas dhe inovativ mësimor. <i>(Evidence 48 – Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit)</i> <i>(Vizita në institucion, turi i ambienteve)</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme	Laboratorët janë të pajisur në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe janë të gatshëm të mbulojnë kërkesat e moduleve, aftësimin teorik dhe praktik, si dhe objektivat formues të programit. Pajisjet dhe mjetet e nevojshme janë të disponueshme për të siguruar një përvojë mësimore të plotë. Po ashtu, institucioni ofron akses në internet përmes Wi-Fi dhe laboratorit i informatikës është i

për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	hapur për studentët, jo vetëm për lëndën përkatëse, por edhe për veprimtari të tjera, duke siguruar një infrastrukturë të plotë për mbështetje mësimore dhe kërkimore. Megjithatë, do të ishte e nevojshme që këto laboratorë të përmirësohen më tej, duke investuar në teknologji dhe pajisje shtesë për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin e aftësive praktike të studentëve duke marrë parasysh edhe natyrën specifike të programit.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<i>(Evidence 48 – Infrastruktura akademike ne funksion te programit te studimit)</i> <i>(Vizita në institucion, turi i ambienteve)</i> <i>(Takimi me studentët)</i>			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni ofron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, me hapësira të bollshme dhe të pajisura me teknologji të avancuar. Laboratorët dhe auditorët janë funksionale dhe të pajisura me aparaturat dhe softuerët e nevojshëm për zhvillimin e mësimin praktik dhe teorik. Laboratorët e specializuar, ofrojnë mundësi për përdorimin e metodave inovative në fushën e imazherisë mjekësore dhe mbështesin zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, prandaj sugjerohet rritje e investimeve në përmirësimin e laboratorëve dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë për të siguruar vazhdimin e cilësisë së lartë mësimore dhe mbështetje për kërkimet e avancuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës së Universitetit. Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve, por <i>sugjerohet një rritje e numrit të literaturës së viteve të fundit.</i> Vlen të theksohet se, Kolegji Universitar Reald për të përmbushur kërkesat e programit të studimit gjithashtu ka akses në një numër bibliotekash on-line. <i>(Evidence 51 – Lista e librave ne fushen e mjekesise)</i> <i>(Evidence 53 – Biblioteka online)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime	GVJ ka konstatuar se njësia përgjegjëse bën kërkesa të vazhdueshme për përditësimin e literaturës, duke përfshirë botime të fundit, në përputhje me zhvillimet e fushës përkatëse. <i>Sugjerohet që literatura e</i>

të literaturës me botime të viteve të fundit.	<i>vënë në dispozicion të studentëve të përditësohet rregullisht për të reflektuar avancimet më të fundit shkencore dhe profesionale si dhe të përditësohen syllabuset me literaturë të pesë viteve të fundit.</i> <i>(Evidence 18 – Syllabuset e lëndëve)</i> <i>(Evidence 51 – Lista e librave në fushën e mjekësisë)</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se biblioteka është në dispozicion të studentëve e pajisur me vende leximi dhe internet. KUR ka disa vjet që vë në dispozicion edhe bibliotekën on-line. Kompjuterat e instaluar në ambientet e bibliotekës ofrojnë akses pa kufizim interneti. <i>(Evidence 48 – Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit)</i> <i>(Evidence 53 – Biblioteka online)</i> <i>(Vizita në institucion, turi i ambienteve)</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Ambientet e bibliotekës vihen në dispozicion të studentëve në përputhje me nevojat e tyre, në përshtatje të orarit mësimor. Institucioni i ka krijuar kushte të përshtatshme çdo studenti për aksesimin e bibliotekës si atë fizike ashtu edhe asaj online. Kapaciteti i bibliotekës është i mjaftueshëm për përdorimin e saj nga një numër i konsiderueshëm studentësh njëkohësisht. <i>GVJ rekomandon pasurimin e bibliotekës edhe me tituj apo tekste shqip të cilat lidhen me këtë program studimi, si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të Programit të Studimit.</i> <i>(Evidence 51 – Lista e librave në fushën e mjekësisë)</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me personelin akademik dhe studentët, GVJ vuri në dukje se Universiteti ka siguruar kushte për akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në bibliotekat online të lidhura me fushën e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të plotë për të shfrytëzuar burimet digjitale të literaturës dhe materialeve mbështetëse përmes platformave online të bibliotekës, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë në përvetësimin e dijeve dhe njohurive të nevojshme. Ky shërbim përbën një mjet të rëndësishëm për mbështetje akademike dhe zhvillimin e kërkimeve shkencore. <i>(Takimi me stafin akademik dhe studentët)</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka e institucionit është e pajisur me teknologji moderne dhe programe kompjuterike, të cilat mundësojnë shfrytëzim të pakufizuar për të gjithë studentët. Biblioteka disponon kompjuterë, softëare të avancuar për kërkime akademike dhe mundësi të tjera teknike që mbështesin zhvillimin e

shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	procesit mësimor dhe kërkimor. Këto pajisje janë të aksesueshme për studentët, duke siguruar një mundësi të barabartë dhe pa pengesa për përdorimin e materialeve dhe burimeve të nevojshme. <i>(Vizita në institucion, turi i ambienteve)</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka ofron orare shërbimi fleksibël dhe të përshtatshme për studentët, të cilat janë në përputhje me oraret e procesit mësimor. Ajo është e hapur edhe përtej orarit të mësimi, duke u përshtatur me numrin dhe kërkesat e studentëve. Ky shërbim i disponueshëm gjatë gjithë ditës siguron mundësi të gjera shfrytëzimi, duke u ofruar studentëve akses të plotë në burimet bibliografike dhe teknologjike të nevojshme për zhvillimin e studimeve të tyre. <i>(Takimi me studentët)</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Referuar rregulloreve të institucionit dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se biblioteka e institucionit së bashku me njësitë përgjegjëse të programit, monitoron dhe raporton rregullisht për cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës. <i>Do të sugjerohej një analizë e saktë e përdorimit të sallave të studimit dhe përpjekjet për pasurimin e vazhdueshëm të literaturës, si dhe identifikimin e kërkesave për tituj të rinj, për të garantuar cilësinë dhe përmirësimin e shërbimeve bibliotekore.</i> <i>(Evidence 48 – Infrastruktura akademike ne funksion te programit te studimit)</i> <i>(Vizita në institucion, turi i ambienteve)</i>
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni ka krijuar kushte të përshtatshme për shfrytëzimin e bibliotekës dhe burimeve akademike nga studentët, duke siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë në fondet fizike dhe online. Biblioteka është e pajisur me teknologji moderne dhe ofron orare shërbimi fleksibël, duke përmbushur nevojat e studentëve dhe personelit akademik.</i> <i>Megjithatë, procesi i përditësimit të literaturës dhe monitorimi i shfrytëzimit të fondit bibliotekor kërkojnë përmirësim, në mënyrë që të sigurohet cilësia e vazhdueshme dhe pasurimi i burimeve të disponueshme, duke i përshtatur ato me nevojat e kërkimeve dhe studimeve akademike të studentëve dhe stafit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Kolegji Universitar Reald disponon një sistem të avancuar të menaxhimit të informacionit, i cili administrojnë të gjithë informacionin e lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre akademike deri në diplomim. Çdo anëtar i stafit dhe student ka adresën e tij të e-mailit, të cilën mund ta aksesojë në çdo moment, si brenda ashtu edhe jashtë universitetit. Përmes platformës së menaxhimit të informacionit, studentët mund të kenë akses të plotë në të dhënat e tyre personale, rezultatet e provimeve përkatëse sipas semestrave ose viteve akademike, si dhe informacion të tjera didaktik që lidhen me përparimin e tyre akademik. Ky sistem ofron një mënyrë efektive për ndjekjen dhe menaxhimin e të dhënave, duke mundësuar një qasje të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë për të gjithë studentët dhe stafin akademik. <i>(Evidence 28 - Rregullore e sekretarisë mesimore)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ vëren se institucioni ka implementuar një sistem të avancuar të menaxhimit të brendshëm, i cili administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetet e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit. Ky sistem siguron koordinim të plotë dhe efikas midis sekretarisë mesimore, stafit akademik dhe studentëve përmes platformës së menaxhimit, e cila ofron akses të dedikuar në informacion dhe dokumente për secilën kategori. Për më tepër, platforma integrohet me sistemin e edukimit në distancë, duke mundësuar komunikimin e drejtpërdrejtë midis pedagogëve dhe studentëve, si dhe mundësinë e shkëmbimit të materialeve mesimore, vlerësimit të projekteve dhe diskutimeve virtuale për çdo modul. Ky sistem i menaxhimit siguron përcjelljen e informacionit në kohë reale, duke mundësuar një qasje të shpejtë dhe të organizuar për të gjitha palët e përfshira: sekretariatit mesimor, përgjegjësin e programit, titullarin, stafin akademik dhe studentët, duke rritur efikasitetin e procesit administrativ dhe mesimor. <i>(Vizita në institucion)</i>

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Kolegji Universitar Reald ka implementuar një sistem të avancuar menaxhimi, i cili integron platforma dhe module të ndryshme që mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni midis personelit akademik dhe studentëve. Ky sistem ofron mundësinë e ndarjes së materialeve mësimore, ofron mbështetje të menjëhershme për pyetje dhe diskutime, si dhe mundëson monitorimin e përpërimit të studentëve në mënyrë të efektshme dhe të vazhdueshme. Platforma të tilla garantojnë një komunikim të lehtë dhe efikas, duke përmirësuar jo vetëm procesin mësimor, por edhe atë administrativ, dhe duke siguruar që të dhënat dhe informacionet të jenë të disponueshme për të gjithë përfshirësit në proces.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	(Vizita ne sekretarine mesimore)			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se Kolegji Universitar Reald publikon informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në faqen e tij të internetit në gjuhën shqipe. Ky informacion është i aksesueshëm për studentët dhe palët e interesuara, duke siguruar transparencë dhe mundësi të barabarta për të gjithë përdoruesit. Nga takimi me njësitë përgjegjëse GVJ u informua që po punohet edhe me versionin në gjuhën angleze dhe italiane. https://unireald.edu.al/			
Konkluzione	GVJ vëren se Institucioni ka krijuar një mjedis efikas dhe të qartë për komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit. Sistemi i menaxhimit mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni të lehtë ndërmjet personelit akademik dhe studentëve, duke përmirësuar procesin mësimor. Informacionet lidhur me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme janë të disponueshme në faqen e internetit në gjuhën shqipe dhe po punohet edhe për përditësimin e informacionit në gjuhën angleze, me qëllim sigurimin e aksesit të barabartë dhe transparencë për të gjithë përdoruesit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Kolegji Universitar Reald harton një raport financiar të detajuar për kostot e programeve të studimit. Ky raport përfshin një analizë të shpenzimeve dhe burimeve financiare të nevojshme për mbështetjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Po ashtu, institucioni ka një plan të strukturuar për mbështetje financiare, duke siguruar që të gjithë resurset e nevojshme për realizimin e programeve të studimit janë të siguruara dhe të menaxhuara në mënyrë efikase. Kjo masë garanton vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e programeve të studimit në afat të gjatë. <i>(Evidence 81 – Raport financiar vjetor)</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Kolegji Universitar Reald (KUR) përgatit një parashikim të detajuar financiar për programin e studimit që përfshin financimin e burimeve njerëzore, mirëmbajtjen e mjediseve, pasurimin e bibliotekës dhe investimet në teknologji mbështetëse. Burimet kryesore financiare vijnë nga tarifat e studentëve dhe grantet kombëtare/internacionale, të cilat shpërndahen sipas buxhetit të miratuar. Pasqyra financiare për çdo vit përfshin të ardhurat, shpenzimet dhe investimet në laboratorë dhe projekte. Raportet financiare tregojnë një gjendje të qëndrueshme financiare dhe rritje ekonomike, që ka mundësuar përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së procesit mësimor. Gjatë vizitës, GVJ u informua për përgatitjen e planit të financimit që mbulon të gjitha kostot, duke përfshirë burimet njerëzore, mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive, si dhe pasurimin e bibliotekës dhe shpenzimet për literaturë. Pasqyrat financiare, të cilat përfshijnë bilancin kontabël, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe fluksin e mjeteve monetare, janë të përgatitura çdo vit dhe sigurojnë një pasqyrë të qartë të gjendjes financiare. Raportet financiare tregojnë një gjendje të qëndrueshme financiare, me rritje ekonomike çdo vit, që ka mundësuar përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Shpërndarja e fondeve bëhet nga Zyra e Financave, sipas zërave të miratuara në buxhet. Institucioni përpilon pasqyrat financiare çdo vit, të cilat pasqyrojnë gjendjen financiare dhe realizimin e buxhetit të planifikuar. Raportet financiare dëshmojnë një situatë financiare të qëndrueshme, me rritje ekonomike nga viti në vit, që ka kontribuar në rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e infrastrukturës akademike të KUR.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	<i>(Evidence 81 – Raport financiar vjetor)</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të	

studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	<i>GVJ vëren se Kolegji Universitar Reald disponon një sistem financiar të mirëstrukturuar, i cili mbështet programet e studimit dhe siguron kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, si dhe përmirësimin e kërkesave infrastrukturore dhe akademike. Planifikimi i saktë i kostove dhe burimeve financiare siguron realizimin e suksesshëm të programeve të studimit gjatë gjithë ciklit akademik. Pasqyrat financiare konfirmojnë një situatë financiare të qëndrueshme dhe një rritje të vazhdueshme ekonomike, e cila ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe infrastrukturës së institucionit.</i>			
Shkalla e përmirësimit të standardit	Nuk përmirësohet	Përmirësohet pjesërisht	Përmirësohet kryesisht	Përmirësohet plotësisht
				X

Shkalla e përmirësimit të standardeve të fushës IV	Nuk përmirësohet	Përmirësohet pjesërisht	Përmirësohet kryesisht	Përmirësohet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Kolegji Universitar Reald ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura që mbulojnë tërësisht ciklin akademik të studentëve, nga pranimi deri në diplomim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tij rregullatore. Këto politika përfshijnë procedurat e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, si dhe procesin e diplomimit, duke siguruar një mbështetje të plotë akademike gjatë gjithë periudhës së studimeve. Institucioni zbaton këto procedura përmes statutit të universitetit dhe rregulloreve të veçanta, si Rregullorja e FSHM-së dhe Rregullorja e

	Programit, të cilat sigurojnë transparencën dhe një proces akademik të rregullt dhe të drejtë për studentët. <i>(Evidenca 2 - Statuti i KUR)</i> <i>(Evidence 4 - Rregullore e Pergjithshme e KUR)</i> <i>(Evidence 5 - Rregullore e Fakultetit FSHM)</i> <i>(Evidence 6 - Rregullore e Programit te studimit)</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimet e ardhura nga njësi bazë, me vendim të senatit, shpallen kriteret dhe modalitetet e pranimit të studentëve, të cilat u bëhen me dije aplikantëve gjatë periudhës së informimit. Pranimi i studentëve realizohet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për ciklin e parë të studimeve, duke respektuar renditjen e aplikantëve sipas pikëzimit të arritur. <i>(Evidence 6 - Rregullore e Programit te studimit)</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Institucioni harton dhe publikon, përpara çdo viti akademik, kriteret të qarta dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programet e studimeve. Këto kriteret janë në përputhje me ligjin dhe udhëzimet përkatëse dhe përfshijnë gjithashtu regjistrimin e studentëve të huaj. Institucioni bashkëpunon ngushtë me strukturat përkatëse për zbatimin e maturës shtetërore, duke siguruar një proces pranimi të drejtpërdrejtë, transparent dhe të rregullt. Pas regjistrimit në regjistrin e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit realizohet regjistrimi online në portalin U-Albania. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sekretari, GVJ vëren se dosjet e studentëve ishin të plota dhe në përputheshje me rregulloret në fuqi. Kushtet dhe procedurat për transferimin dhe njohjen e krediteve bëhen të qarta nga koordinatori i programit. <i>(Evidence 6 - Rregullore e Programit te studimit)</i> <i>(Evidence 28 - Rregullore e sekretarise mesimore)</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kolegji Universitar Reald ka përcaktuar dhe publikuar kriteret dhe procedura të qarta për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve, përparimin e tyre gjatë kursit të studimit, transferimin e krediteve, njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimin e dijeve dhe procesin e diplomimit. Këto procedura janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për publikun, duke siguruar transparencë dhe mundësi të barabarta për studentët dhe të interesuarit. <i>(Evidence 6 - Rregullore e Programit te studimit)</i>

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Kolegji Universitar Reald, përpara fillimit të çdo viti akademik, informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programeve të studimit. Ky informacion është i detajuar, i qartë dhe i aksesueshëm për të gjithë, duke siguruar që kandidatët dhe studentët e mundshëm të kenë njohuri të plota mbi kushtet dhe kërkesat e programeve përkatëse. Ky proces mundëson një pranimin dhe planifikim të qartë, të drejtpërdrejtë dhe të bazuar në informacione të sakta për të gjitha palët e interesuara. <i>(Evidence 6 - Rregullore e Programit te studimit)</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Kolegji Universitar Reald harton dhe publikon përpara fillimit të çdo viti akademik kriteret të qarta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Këto kriteret janë të aksesueshme dhe të dizajnuara për të siguruar mundësi të barabarta pranimi për të gjithë kandidatët, pa diskriminim, duke mbështetur përfshirjen e këtyre grupeve në procesin e arsimit të lartë. Gjithashtu, para çdo fillimi viti akademik dhe brenda afateve të përcaktuara nga MAS për aplikimet, në ambientet e Universitetit organizohet fushata e informimit. Stafi i ngarkuar për informim pret dhe jep informacionin e nevojshëm për pranim, duke siguruar që të gjithë të interesuarit të kenë mundësinë të informohen dhe të aplikojnë për programet e studimit në mënyrë të qartë dhe të plotë. <i>(Evidenca 2 - Statuti i KUR)</i> <i>(Evidence 4 - Rregullore e Pergjithshme e KUR)</i> <i>(Evidence 5 - Rregullore e Fakultetit FSHM)</i> <i>(Evidence 6 - Rregullore e Programit te studimit)</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kolegji Universitar Reald harton dhe publikon përpara fillimit të çdo viti akademik kriteret të qarta për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Këto kriteret janë të aksesueshme dhe ofrojnë informacion të detajuar për të mundësuar procesin e pranimin të studentëve ndërkombëtarë. Ky veprim siguron që kandidatët nga shtete të tjera të kenë mundësi të barabarta për t'u pranuar në programet e studimit, duke ndihmuar në promovimin e diversitetit dhe ndërkombëtarizimit të institucioni. <i>(Evidence 6 - Rregullore e Programit te studimit)</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për	Nga vizita në Institucion dhe takimet e zhvilluara, GVJ konstatoi se me vendim te Bordit te Administrimit akordon bursa për studentët ekselentë, duke ofruar mundësi për kandidatët që shfaqin rezultate të larta akademike.

institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	(Evidence 85 – Vendim nr. 4. Dt. 25.05.2022 “Per trajtimin e studenteve me status te vecante dhe miratimin e bursave)			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni ka një sistem të mirëstrukturuar dhe të qartë për pranimin e studentëve, i cili përfshin politika dhe kriteret të përcaktuara për kategoritë e ndryshme të kandidatëve, përfshirë ata me aftësi të veçanta, nga shtete të tjera, dhe ata nga shtresat në nevojë. Institucioni siguron transparencë në publikimin dhe komunikimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin e studentëve përpara çdo viti akademik, duke garantuar mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët potencialë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se njohja me rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë, si dhe kriteret për kalimin në vitin pasardhës, janë përgjegjësi e programit dhe realizohen si detyrim institucional. Kolegji Universitar Reald siguron informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve, si dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është i aksesueshëm për studentët dhe të interesuarit, duke garantuar që ata të kenë njohuri të plota rreth kushteve dhe procedurave përparimore, vlerësimit të rezultateve dhe kalimit në vitet e ardhshme. Ky proces mundëson një mjedis transparent dhe të drejtë për të gjithë studentët. <i>(Evidence 6 - Rregullore e Programit te studimit)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Referuar RVB-së, kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe transferimin e krediteve janë të përcaktuara në Rregulloren e Kolegji Universitar Reald dhe specifikohen në Rregulloren e programit të studimit. Ekuivalentimi dhe njohja e krediteve të fituara nga kandidati gjatë studimeve të mëparshme realizohet nga Komisioni i Ekuivalentimit, i ngritur nga Dekani i Fakultetit. Syllabuset e moduleve përcaktojnë elementët e veçantë të vlerësimit të njohurive, përfshirë pikëzimin dhe konvertimin në notë. Studentëve iu bëhet me dije nga pedagogu përgjegjës për modulën, ditën e parë të mësimi. Ky proces siguron një kalim të drejtë dhe transparent të krediteve të fituara, duke ndihmuar studentët të ndërtojnë një rrugë të qartë akademike. <i>(Evidence 4 - Rregullore e Pergjithshme e KUR)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje	Informimi në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit është i përcaktuar në

me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregulloren e Programit të Studimit. Po ashtu, në syllabuset e moduleve përcaktohen elementët e veçantë të vlerësimit të njohurive, pikëzimi dhe konvertimi i tyre në notë. Studentëve iu bëhet me dije nga pedagogu përgjegjës për modulin, në ditën e parë të mësimin, për të siguruar një kuptim të qartë të procedurave të vlerësimit dhe për të garantuar transparencë dhe drejtësi në procesin e vlerësimit. <i>(Evidence 6 - Rregullore e Programit të studimit)</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Referuar akteve rregullatore dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se Kolegji Universitar Reald siguron informimin e studentëve në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Në fillim të ciklit të studimeve, Përgjegjësi i programit informon studentët për procedurën e diplomimit, duke u dhënë atyre kohë për të zgjedhur fushën e studimit. <i>(Evidenca 27 - Rregullore e diplomimit)</i> <i>(Evidenca 30 – Udhezim për punimin e diplomes)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Çdo fillim viti, studentëve iu vihet në dispozicion informacioni mbi programin e studimit përmes kanaleve të ndryshme, siç janë faqja zyrtare e institucionit, katalogu i shkollës, fletët informuese, sekretaria, zyra e karrierës, stafi akademik dhe përgjegjësi i programit. Po ashtu, institucioni organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, mundësitë e ofruara dhe kërkesat e nevojshme për regjistrim. Ky proces informimi i detajuar dhe transparent siguron që studentët të kenë mundësinë të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të përgatiten për programet e studimit në institucion, duke kontribuar në një proces të qartë dhe të drejtë pranimit dhe orientimit.			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni ka një proces të qartë dhe të hapur për informimin e studentëve dhe të interesuarve në lidhje me kriteret dhe procedurat e ndryshme akademike. Institucioni siguron transparencë të plotë për kriteret e përparimit akademik, vlerësimit, punimit të diplomës dhe diplomimit, duke ofruar udhëzues të detajuar dhe organizuar takime informuese për studentët e ardhshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ thekson se studentët janë të informuar në mënyrë të detajuar mbi strukturën dhe organizimin e procesit mësimor, përfshirë orët e teorisë dhe të praktikës, si dhe periudhat e provimeve, përmes kalendarit akademik të ofruar nga përgjegjësi i programit. Në lidhje me planin mësimor, lëndët dhe modulet, studentëve u vihet në dispozicion katalogu i shkollës, si edhe tabela informuese të vendosura në auditoret e leksioneve. Këto mjete sigurojnë që studentët të kenë një kuptim të plotë dhe të qartë mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe aktivitetet formuese që përfshihen në procesin mësimor. <i>(Evidenca 80 – Poster per informimin e publikimit te informacionit per programet e studimit qe ofrohen ne IAL)</i> <i>(Takimi me studentet)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni garanton ofrimin e informacionit të plotë dhe lehtësisht të aksesueshëm për studentët në lidhje me lëndët dhe modulet e programit të studimeve, përmes udhëzuesve të detajuar që përfshijnë objektivat mësimore, përmbajtjen, metodat e vlerësimit dhe aktivitetet formuese. Ky informacion është i disponueshëm në katalogët akademikë, në materialet online të publikuara, si dhe në formë fizike nëpër auditorë. Për çdo lëndë, studentët kanë akses në oraret, kalendarët dhe udhëzuesit përkatës, të cilët përmbajnë të gjitha detajet mbi aktivitetet teorike dhe praktike. Kjo u mundëson atyre një përgatitje të plotë, të strukturuar dhe të përditësuar për ndjekjen e suksesshme të programit të studimeve. <i>(Takimi me studentet)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ofron informacion të plotë dhe mbështetje të vazhdueshme për orientimin e studentëve drejt tregut të punës përmes Zyrës së Karrierës, e krijuar posaçërisht për këtë qëllim. Kjo zyrë është aktive në zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe profesionale, duke ruajtur kontakte të rregullta me studentët dhe të diplomuarit për të ndjekur dhe përkrahur zhvillimin e karrierës së tyre. Ajo ofron asistencë të specializuar për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm si CV, letra motivimi dhe dokumente të tjera që ndihmojnë studentët të përballen me sukses me kërkesat e tregut të punës. Përmes Zyrës së Karrierës, studentët informohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme mbi mundësitë për praktika profesionale, punësim dhe zhvillim të mëtejshëm profesional. Këto mundësi promovohen përmes orareve mësimore, aktiviteteve praktike dhe kontakteve të drejtpërdrejta me tregun e punës. Zyra luan gjithashtu një rol ndërmjetësues, duke krijuar lidhje midis studentëve dhe punëdhënësve dhe duke ndihmuar konkretisht në procesin e punësimit të të diplomuarve. <i>(Evidence 37, 37 – Lista e Marreveshjeve te bashkepunimit)</i>

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni siguron informacion të përditësuar dhe të detajuar në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor, duke përfshirë oraret, praktikat dhe aktivitetet e tjera akademike. Ky informacion bëhet i aksesueshëm për studentët përmes platformave online, si dhe në mënyrë fizike nëpërmjet tabelave informuese të vendosura në auditorë dhe zyra përkatëse. Përveç të dhënave akademike, studentët informohen edhe mbi aspektet logjistike të procesit mësimor, si ndarja e auditorëve, disponueshmëria e materialeve didaktike dhe shërbimet mbështetëse që i ndihmojnë ata gjatë rrugëtimit të tyre akademik. Infrastruktura institucionale, përfshirë bibliotekat, laboratorët dhe pajisjet teknologjike, është e dokumentuar dhe e aksesueshme për të gjithë studentët, duke ofruar kushte të përshtatshme për zhvillimin cilësor të mësimdhënies dhe të të nxëniet. Gjithashtu, shërbimet mbështetëse, si asistenca teknike dhe mbështetja administrative për studentët, janë të organizuara në mënyrë të tillë që të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të mirëinformuara, duke garantuar një eksperiencë të plotë dhe të efektshme akademike. <i>(Evidence 48 – Infrastruktura akademike ne funksion te programit te studimit)</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni garanton që informacioni i lidhur me programin e studimeve përfshirë përmbajtjen e lëndëve, oraret, praktikat dhe detajet mbi procesin e vlerësimit të jetë lehtësisht i aksesueshëm për studentët përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit. Platforma e menaxhimit karakterizohet nga një ndërfaqe e thjeshtë dhe e përdorshme, e cila u mundëson studentëve të konsultojnë materialet mësimore, të ndjekin njoftimet e rëndësishme dhe të menaxhojnë detyrat e tyre akademike në mënyrë të qetë dhe pa pengesa.			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni ka ngritur një sistem të strukturuar dhe efikas për informimin e studentëve lidhur me mundësitë që ofrohen gjatë procesit mësimor, si dhe për mbështetjen e vazhdueshme në orientimin e tyre drejt tregut të punës. Institucioni siguron një informacion të plotë, të përditësuar dhe lehtësisht të aksesueshëm mbi lëndët, modulet, aktivitetet formuese dhe mundësitë për zhvillim profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni garanton mbajtjen dhe përditësimin e statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në çdo program studimi. Këto të dhëna përfshijnë informacion të detajuar mbi procesin e pranimit, përfundimin e studimeve dhe normat e diplomimit. Statistikat janë të strukturuar dhe të disponueshme për analiza të brendshme, si dhe ofrohen në mënyrë transparente për palët e interesuara. Me anë të këtyre të dhënave, institucioni monitoron dhe vlerëson performancën e programeve akademike dhe ofron autoriteteve përkatëse informacion të vlefshëm për planifikimin dhe zhvillimin e politikave akademike në të ardhmen. <i>(Evidence 87 – Te dhena per regjistrimin e studenteve)</i> <i>(Evidence 88 – Te dhena per punesimin e studenteve)</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni mban në sekretarinë mësimore statistikat vjetore të numrit të studentëve të regjistruar në programet e studimit, duke përfshirë të dhënat mbi diplomimin, tërheqjet nga programi dhe largimet para përfundimit të studimeve për çdo program. Universiteti ka gjithashtu dokumentacionin vjetor që tregon numrin e studentëve të regjistruar, ngrirjen e studimeve dhe largimin e studentëve gjatë periudhës së studimeve. Ky informacion ruhet dhe menaxhohet në kohë reale përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të të dhënave, i administruar nga sekretaria mësimore. Përveç kësaj, institucioni disponon të dhëna mbi ecurinë e studentëve, të cilat janë të ruajtura si dokumentacion fizik (procesverbale, regjistra) dhe në formatin elektronik. <i>(Evidence 87 – Te dhena per regjistrimin e studenteve)</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave, informacioni mund të përditësohet dhe modifikohet vetëm nga individë të autorizuar, në përputhje me pozitat dhe detyrat e tyre. Ndërkohë, mundësia për të aksesuar të dhënat pa të drejtë manipulimi është e kufizuar për një grup të ngushtë personash të autorizuar. <i>(Evidence 28 - Rregullore e sekretarisë mesimore)</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson	Institucioni siguron një proces të rregullt dhe të përvitshëm kontrolli dhe monitorimi pranë të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin, përfshirë sekretaritë mësimore dhe sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit. Ky kontroll periodik ka për qëllim vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së informacionit dhe dokumentacionit të lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre akademike. Përmes këtij procesi, institucioni garanton saktësinë dhe

dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	përditësimin e të dhënave, si dhe ruajtjen e cilësisë së informacionit dhe dokumenteve që përdoren për menaxhimin e proceseve akademike. (Evidence 28 - Rregullore e sekretarisë mesimore) (Evidenca 65 Raport vjetor i IAL)			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia bazë merret me hartimin e raporteve analitike dhe periodike që vlerësojnë cilësinë dhe profilin e studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe analizojnë nivelin e suksesit të punësimit pas diplomimit. Ky proces përfshin mbledhjen e të dhënave mbi suksesin akademik të studentëve dhe mundësitë e punësimit, duke propozuar masa konkrete për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të programeve akademike dhe shërbimeve mbështetëse. Raportet ofrojnë një pasqyrë të detajuar të aspekteve që mund të përmirësohen dhe mundësive për të rritur suksesin e studentëve dhe diplomuarve në tregun e punës. (Evidenca 65 Raport vjetor i IAL)			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni ka një sistem të strukturuar dhe efikas për mbledhjen, menaxhimin dhe përditësimin e informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre akademike. Përmes kontrollit periodik dhe raporteve analitike, institucioni siguron që të dhënat mbi profilin e studentëve, cilësinë e punësimit dhe rezultatet akademike janë të sakta dhe të aksesueshme për analizë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Statuti dhe rregullorja e institucionit parashikojnë pjesëmarrjen e studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë." Studentët organizohen në Senatin Studentor, ku çdo grup mësimor ka një senator përfaqësues, dhe janë gjithashtu të përfshirë në komisione të tjera, si në NJSBC dhe GVB, ku ata ushtrojnë rolin e përfaqësuesve. (Evidence 2 – Statuti i KUR) (Evidence 2 – Rregullore e Përgjithshme e KUR)

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ vëren se Kolegji Universitar Reald ka një sistem të qartë dhe efektiv për përfshirjen e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje dhe këshillime mbi procesin akademik. Përfshirja e studentëve është reale dhe konkrete, duke u mundësuar atyre të jenë pjesë aktive e Senatit Studentor dhe të komisioneve të tjera si NJSBC dhe GVB. Ky proces ofron mundësi të barabarta për studentët për të shprehur mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e cilësisë akademike. (Evidence 2 – Statuti i KUR) (Evidence 2 – Rregullore e Pergjithshme e KUR) (Takimi me stafin, Takimi me studentët)			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Kolegji Universitar Reald siguron një përfshirje aktive dhe të rregullt të studentëve në proceset e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Njësitë përgjegjëse organizojnë takime të përbashkëta me departamentet, ku studentët mund të japin mendimet dhe sugjerimet e tyre për programet e studimit. Për më tepër, NJSBC kryen pyetësorët e studentëve, ku studentët kanë hapësirën e tyre për të shprehur mendimeve, sugjerimeve apo kritikave. Sugjerimet dhe kontributet e tyre reflektohen në përmirësimet e programeve të studimit, duke garantuar që ato të përmbushin nevojat dhe pritshmëritë e studentëve dhe të rrisin cilësinë e procesit mësimor. (Evidence 57 - Rregullore e NJSBC) (Evidenca 56 – Raport vjetor i NJSBC) (Evidenca 61 – Pyetësor NJSBC per studentet) (Takimi me stafin, Takimi me studentët)			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët shfrytëzojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në dokumentet rregullatorë, të cilat respektohen nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtën të informohen për rezultatet e provimeve, të shprehin mendime mbi to dhe të ndjekin të gjitha procedurat e ankimimit për rivlerësim. Nga takimet me stafin akademik dhe studentët, është vënë re se atmosfera në institucion është shumë pozitive. Filozofia e institucionit është që studentët të vlerësohen në mënyrë të drejtë dhe të përvetësojnë sa më shumë dije gjatë periudhës së studimeve të tyre. (Takimi me stafin, Takimi me studentët)			
Konkluzione	GVJ kontstaon se, Institucioni ka zhvilluar një sistem ku studentët janë aktivisht të përfshirë në proceset vendimmarrëse dhe përmirësuese të programeve akademike, duke ofruar mundësi konkrete dhe efektive për të kontribuar në përmirësimin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit të zhvilluar me studentët, GVJ kërkoi informacione më të detajuara në lidhje me procedurat dhe njësitë përgjegjëse për informimin e studentëve dhe shërbimet e ofruara për ta, duke siguruar se këto janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet rregullatore të arsimit të lartë. Informacionet kyçe për studentët janë të disponueshme në faqen zyrtare të institucionit si dhe studentët konfirmuan që janë në komunikim të vazhdueshëm me personelin akademik. Po ashtu, zyra e këshillimit të karrierës dhe alumni ofron mbështetje dhe informacion të strukturuar për studentët që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tyre, duke siguruar gjithashtu mundësi për orientimin në tregun e punës. <i>(Evidence 7 - Rregullore e Keshillimit te Karrieres)</i> <i>(Takimi me stafin, Takimi me studentët)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ vëren se Kolegji Universitar Reald ka krijuar dhe ka bërë funksional një sistem të strukturuar dhe efikas për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre në çështje të lidhura me procesin mësimor dhe programin e studimit. Ky sistem ofron shërbime të qëndrueshme mbështetëse për studentët, duke siguruar informacion dhe udhëzime të vazhdueshme për çdo aspekt të përparimit akademik. Njësitë përgjegjëse, si koordinatori i programit dhe departamentet përkatëse, janë të angazhuara në monitorimin e progresit të studentëve, në ofrimin e asistencës për zhvillimin e programit mësimor dhe në zgjidhjen e çdo çështjeje që mund të lindë gjatë studimeve. <i>(Evidence 7 - Rregullore e Keshillimit te Karrieres)</i> <i>(Evidence 28 - Rregullore e sekretarisë mesimore)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me	GVJ konstatoi se Kolegji Universitar Reald ka ngritur infrastruktura të veçanta organizative dhe logjistike për të mbështetur studentët në procesin e orientimit dhe zhvillimit të karrierës së tyre. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni siguron një mbështetje të vazhdueshme për studentët, duke i informuar periodikisht për kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Përmes një ndërmjetësimi efikas ndërmjet interesave dhe potencialeve të dy palëve, kjo zyrë mundëson realizimin e kërkesave të tregut të punës dhe ofron mundësi për punësimin e

kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	studentëve të diplomuar, duke i lidhur ata me mundësi konkrete në tregun e punës. (Evidence 7 - Rregullore e Këshillimit të Karrierës) (Evidence 88 – Te dhëna për punësimin e studentëve)			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ, gjatë vizitë së zhvilluar në Institucion dhe dokumentacionit shoqërues të RVB-së, konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni mbledh, përpunon, ruan të dhënat si dhe harton raporte mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të Programit të Studimit. (Evidence 7 - Rregullore e Këshillimit të Karrierës) (Evidence 88 – Te dhëna për punësimin e studentëve)			
Konkluzione	GVJ konstaton se Institucioni ka zhvilluar një sistem të strukturuar për informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për çdo çështje që ka të bëjë me procesin mësimor dhe programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Referuar RVB-së, Kolegji Universitar Reald ka hartuar strategjine e zhvillimit të detajuar në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të cilat janë të përshtatura për lëndët dhe modulet specifike të programit të studimit. Aktet rregullatore institucionale ofrojnë gjithashtu orientime të qarta për pedagogët mbi mënyrat e ndryshme të mësimdhënies, përfshirë metodat tradicionale dhe ato më moderne, të tilla si mësimi i integruar, përdorimi i teknologjisë dhe mësimi aktiv. Përdorimi i metodave inovative është i fokusuar në rritjen e angazhimit të studentëve dhe përmirësimin e rezultateve të mësimi, duke i

	mundësuar atyre të përvetësojnë njohuri në mënyrë më të efektshme dhe të zhvillojnë aftësi praktike dhe kritike. Kjo qasje e strukturuar kontribuon në përmirësimin e cilësisë akademike dhe ofron mundësi të reja për zhvillimin e studentëve në fushat e studimeve të tyre. <i>(Evidence 2 - Statuti i Kolegjit Universitar REALD)</i> <i>(Evidence 4 - Rregullore e përgjithshme e IAL)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë është përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin periodik të mësimdhënies. Indikatorët e përdorur nga kjo njësi reflektohen në formularin e performancës së pedagogut. Kjo njësi përgatit raportin përfundimtar, në të cilin evidentohen problematikat dhe mundësitë për përmirësim. Objektivi kryesor i kësaj njësie është të identifikojë praktikat efektive që kontribuojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të sigurojë një proces të vazhdueshëm për përmirësimin e standardeve akademike. Ky mekanizëm mbështet përpjekjet për zhvillimin dhe implementimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe siguron një pasqyrë të qartë mbi arritjet dhe sfidat që hasen gjatë këtij procesi. <i>(Evidence 57 - Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Evidenca 56 – Raport vjetor i NJSBC)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në fund të semestrit dhe në mënyrë periodike, studentëve u kërkohet të plotësojnë një pyetësor për vlerësimin e pedagogëve dhe të programit të lëndëve. Pyetësi përmban një seri pyetjesh që synojnë vlerësimin e aspekteve të ndryshme të lëndës dhe performancës së pedagogut. Po ashtu, studentët janë vazhdimisht në kontakt me koordinatorin e programit për të paraqitur problematikat e tyre. Rezultatet e pyetësit analizohen dhe vlerësohen me qëllim përmirësimin e indikatorëve dhe treguesve të cilësisë akademike në institucion. Pas analizës, përgatitet raporti përfundimtar, i cili përfshin rekomandime dhe masat përkatëse për përmirësimin e procesit mësimor dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve akademike. <i>(Evidence 57 - Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Evidenca 56 – Raport vjetor i NJSBC)</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Referuar formatit të pyetësit, pyetësi për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndës është një nga elementët kyç që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies. Ky pyetësor për studentët përmban një analizë të detajuar me gjetjet dhe konstatimet lidhur me performancën e pedagogëve dhe përmbajtjen e lëndëve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është struktura përgjegjëse për analizimin e këtyre gjetjeve dhe i'a përcjell ato Senatit Akademik për diskutim dhe shqyrtim. Pas kësaj, NJSBC harton një plan aktiviteteesh për të adresuar kërkesat dhe sugjerimet e studentëve, duke siguruar

	përmirësimin e cilësisë akademike dhe rritjen e efektivitetit të mësimdhënies dhe të programeve të studimit. (Evidence 57 - Rregullore e NJSBC) (Evidence 58. Plan vjetor i aktiviteteve të NJSBC - viti akademik 2023-2024) (Evidence 59. Formular NJSBC - Vlerësim i studentit për pedagogun) (Evidence 61. Pyetësor i NJSBC që plotësohet nga studenti për aktivitetin në IAL)			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Rezultatet e përftuara nga pyetësi dhe nga vlerësimi i performancës reflektohen në dosjen individuale të personelit akademik. Institucioni promovon shembuj të praktikave më të mira dhe inkurajon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe mundësi për zhvillim profesional. Gjithashtu, institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare dhe inkurajon mobilitetin e stafit përmes projekteve të Erasmus+. Këto iniciativa synojnë rritjen e cilësisë akademike, zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale dhe shkëmbimin e përvojave me institucione të tjera arsimore ndërkombëtare. (Evidenca 56 – Raport vjetor i NJSBC) (Evidence 37. Lista e subjekteve me të cilat IAL ka marrëveshje për zhvillimin e praktikave profesionale)			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni ka një sistem të strukturuar dhe të mirëfilltë për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, i cili përfshin përdorimin e pyetësorëve për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndëve, si dhe vlerësimin e performancës së personelit akademik. Institucioni siguron mundësi të vazhdueshme trajnimi dhe zhvillimi profesional për stafin akademik dhe mbështet mobilitetin ndërkombëtar përmes bashkëpunimeve dhe projekteve të Erasmus+			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe	GVJ vëren se Kolegji Universitar Reald ka krijuar dhe zbatuar politika, struktura dhe procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me aktet rregullatore institucionale. Ky sistem siguron që cilësia e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të mbështetura akademike të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë të

me aktet rregullatore institucionale.	vazhdueshme dhe të strukturuar. Përmes këtij sistemi, institucioni implementon dhe përmirëson procedurat e menaxhimit të cilësisë në çdo nivel, duke përfshirë vlerësimin e performancës së pedagogëve, proceset e studimit dhe ofrimin e shërbimeve të tjera për studentët. Ky mekanizëm i sigurisë së cilësisë është i projektuar për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të institucioneve akademike dhe për të garantuar përmbushjen e standardeve të larta të arsimit. <i>(Evidence 57 - Rregullore e NjSBC)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ vëren se Kolegji Universitar Reald ka ngritur dhe mban në funksion një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë, i cili siguron një strukturë të organizuar dhe efikase për menaxhimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike. Institucioni ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji të qartë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, e cila përfshin angazhimin e studentëve, stafit akademik dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Kjo strategji është e orientuar drejt monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të proceseve të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe administratës, duke siguruar një përfshirje të gjerë të të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin edukativ. Pjesëmarrja e ekspertëve të jashtëm dhe e studentëve në këtë proces garanton një perspektivë të plotë dhe objektive, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe eficiencës së arsimit të ofruar. <i>(Evidence 57 - Rregullore e NjSBC)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ vëren se Kolegji Universitar Reald përdor një gamë të gjerë instrumentesh dhe treguesish për të siguruar cilësinë në arsimin e lartë. Institucioni ka implementuar procese të rregullta të vlerësimit të jashtëm, përfshirë akreditimin e programeve të studimit, si dhe vlerësime analitike e krahasuese që i mundësojnë atij të monitorojë dhe përmirësojë cilësinë e ofruar. Ky proces siguron që të gjitha programet akademike të përmbushin standardet e kërkuara dhe të jenë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Përveç vlerësimit të jashtëm, institucioni angazhon gjithashtu procese të brendshme që fokusohen në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të cilësisë, duke përfshirë vlerësimin e performancës së pedagogëve dhe të studentëve. Kjo qasje e shumëfishtë promovon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe siguron që programet e studimit të jenë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës dhe të shoqërisë. <i>(Evidence 57 - Rregullore e NjSBC)</i> <i>(Evidence 58. Plan vjetor i aktiviteteve të NJSBC - viti akademik 2023-2024)</i> <i>(Evidence 59. Formular NJSBC - Vlerësim i studentit për pedagogun)</i> <i>(Evidence 61. Pyetësor i NJSBC që plotësohet nga studenti për aktivitetin në IAL)</i>

Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ vëren se Kolegji Universitar Reald përdor tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor për të pasqyruar gjendjen aktKURE, arritjet dhe dobësitë në këto fusha. Këta tregues janë të integruar në aktet rregullatore të institucionit dhe shërbejnë si një mjet efikas për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Nëpërmjet përdorimit të këtyre treguesve, institucioni është në gjendje të identifikojë fushat ku është arritur sukses dhe ato ku nevojiten përmirësime. Gjithashtu, institucioni përdor këta tregues cilësorë për të nxitur dhe promovuar arritjet më të mira, duke ofruar mundësi avancimi për studentët dhe stafin akademik që kanë kontribuar në arritjen e rezultateve të shkëlqyera. Kjo politikë stimulon një kulturë të vazhdueshme përmirësimi dhe motivon të gjithë aktorët e përfshirë në procesin akademik për të arritur standarde të larta në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. <i>(Evidence 2 - Statuti i Kolegjit Universitar REALD)</i> <i>(Evidence 4 - Rregullore e përgjithshme e IAL)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni ka implementuar një sistem efikas për përdorimin e treguesve të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, të cilët ndihmojnë në pasqyrimin e gjendjes dhe identifikimin e arritjeve dhe dobësive. Përmes treguesve cilësorë, institucioni është në gjendje të nxisë arritjet më të mira, duke motivuar studentët dhe stafin akademik për të arritur nivele të larta të performancës dhe duke siguruar një mjedis të qëndrueshëm për zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm në programet e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon	GVJ vëren se Kolegji Universitar Reald ka zhvilluar dhe përdor mekanizma të formalizuar dhe të dokumentuar për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit të ciklit të parë. Ky proces është i mbështetur në kritere të qarta dhe të matshme, të cilat kontribuojnë në akreditimin e programeve dhe sigurojnë që ato të përmbushin standardet e kërkuara. Gjatë këtij shqyrtimi, identifikohen arritjet dhe dobësitë, ndërsa praktikatat dhe arritjet më të mira motivojnë zhvillimin e mëtejshëm të programit. Njëkohësisht, bëhet një planifikim për masat për

evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	përmirësim, duke siguruar që procesi të mbetet i qëndrueshëm dhe të rritet cilësia e programeve. Rezultatet e këtyre vlerësimeve janë të dokumentuara dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse për të mundësuar veprime të mëtejshme për përmirësimin dhe zhvillimin e programeve të studimit. <i>(Evidence 31. Raport i njesise baze lidhur me programin e studimit)</i> <i>(Evidence 56. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024)</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstaton se, raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme dhe ato të arritura, duke reflektuar praktikën më të mira dhe arritjet e personelit akademik dhe studentëve. Ato gjithashtu ofrojnë një analizë të dobësive të identifikuara dhe masat për adresimin e këtyre mangësive, duke përfshirë rristurimin e programeve, përmirësimin e standardeve akademike, dhe fuqizimin e infrastrukturës mësimore. Njësia ofruese e programit të studimit, së bashku me NJSBC, realizon rristurimin e programeve në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore, si dhe standardet dhe kriteret akademike. Pjesë e këtij procesi është edhe shqyrtimi i cilësisë dhe numrit të stafit akademik, përdorimi i teknologjisë bashkëkohore dhe përzgjedhja e teksteve universitare. KUR siguron një proces të rregullt dhe formal të shqyrtimit dhe miratimit të programeve, me mbikëqyrje të rregullt për të siguruar që ato përmbushin standardet e akreditimit dhe nevojat e studentëve. Në procesin e vetëvlerësimit, institucioni mbledh dhe analizon të dhëna cilësore dhe sasiore nga burime të ndryshme për të monitoruar përmbushjen e standardeve akademike dhe për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Në rastin e akreditimit, raporte të detajuara hartohen nga GVB dhe miratohen nga Senati Akademik për të siguruar që programet e studimit të qëndrojnë të përditësuara dhe të përputhura me kërkesat më të larta të cilësisë. <i>(Evidence 31. Raport i njesise baze lidhur me programin e studimit)</i> <i>(Evidence 56. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024)</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të	GVJ konstatoi që Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të hartimit dhe korigjimit të provimeve, rishikimin e kurikulës, etj. Këto metoda përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese. Megjithatë, nuk janë vërejtur raste të vlerësimit paralel të provimeve apo detyrave të kursit, as vëzhgime në auditor. Po ashtu, testime të standardizuara nuk janë realizuar deri më tani. Në vend të këtyre praktikave, stafi akademik bazohet në pyetjet e provimit të shtetit për profesionet e rregulluara, të cilat përdoren si

provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	udhëzues në hartimin e tezave të provimeve. Ky proces mund të përmirësohet më tej për të siguruar një vlerësim më të plotë dhe gjithëpërfshirës të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidence 6. Rregullore e programit Bachelor ne Teknik ne Radiologji Mjekesore Imazheri dhe Radioterapi)</i> <i>(Evidence 26. Rregullore per Zhvillimin e Provimeve)</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ konstaton se, Institucioni përdor disa instrumenta të tërthortë për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit, si pyetësorët për lëndën, pyetësorët për kënaqësinë me stafin akademik, pyetësorët për kënaqësinë e studentëve me shërbimet, si dhe pyetësorët për alumni. Vlerësimi i pedagogëve realizohet në fund të çdo semestri, nga llogaria personale e studentëve, para fillimit të provimeve. Departamenti përgatit raporte mbi rezultatet e anketave, të cilat përpunohen dhe përdoren për vlerësimin dhe përmirësimin e mbarëvajtjes së programit. GVJ konstaton, mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar dhe takimet e realizuara, se këto instrumenta përdoren periodikisht dhe kanë kontribuar në përmirësimin e programit të studimit. Gjithashtu, KUR përdor metodologji të qarta për vlerësimin e performancës akademike, duke përfshirë treguesit e performancës dhe pyetësorët e studentëve. Strukturat e SBC, Dekani i Fakultetit dhe përfaqësuesi i NJSBC në programin e studimit mbikqyrin zbatimin e programit mësimor dhe sigurojnë se raportet e rezultateve të pyetësorëve kalojnë nëpërmjet Rektoratit dhe Senatit Akademik për të marrë masat dhe vendimet e duhura për përmirësimin e cilësisë dhe performancës. Cdo fund vit akademik, NJSBC publikon Raportin Vjetor, në të cilin përfshihet plani i masave për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët. <i>(Evidence 31. Raport i njesise baze lidhur me programin e studimit)</i> <i>(Evidence 56. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024)</i> <i>(Evidence 57 - Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Evidence 58. Plan vjetor i aktiviteve te NJSBC - viti akademik 2023-2024)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni ka implementuar një sistem të strukturuar për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, duke përdorur metoda dhe instrumente të tërthorta si sondazhe dhe intervista me studentë, alumni dhe punëdhënë. Raportet e vlerësimit dhe masat e marrë për adresimin e mangësive janë të shpërndara dhe miratohen përmes strukturave të vendimmarrjes të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	IAL ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë ku përfshihen, NJSBC, Departamentet dhe Fakulteti në të gjitha hallkat e sigurimit të cilësisë, duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në përbërje të NJSBC ka aktorë që përfaqësojnë grupe të ndryshme interesi, nga një anëtar për cdo fakultet, një ekspert të jashtëm si dhe një përfaqësues studentësh, me një synim të përbashkët: përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidence 57 - Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Evidence 92. Tabelat permbljedhese per Aneks RVB - Ba. Teknik ne Radiologji mjekesore Imazheri dhe Radioterapi)</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se strukturat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë të definuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Këto aktet rregullatore specifikojnë në mënyrë të detajuar mënyrën e krijimit të organeve përkatëse, funksionet kryesore të tyre, proceset e vendimmarrjes dhe ndërveprimin me njësitë e tjera të institucionit. GVJ vëren se detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi sigurojnë ushtrimin e duhur dhe me përgjegjësi të proceseve të sigurimit të cilësisë. <i>(Evidence 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD)</i> <i>(Evidence 57 - Rregullore e NJSBC)</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Sipas dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ vëren se në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit përfshihen në mënyrë aktive njësitë bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin, si dhe të gjithë anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ. Po ashtu, studenti dhe përfaqësuesit e tij janë të përfshirë në vlerësimin e programit përmes pyetësorëve dhe diskutimeve të organizuara. Ky proces garanton një përfshirje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar, duke siguruar një vlerësim të plotë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit. <i>(Evidence 57 - Rregullore e NJSBC)</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të	GVJ konstaton se institucioni ka procedura dhe mekanizma të qarta që sigurojnë përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në

brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	proceset ciklike të vlerësimit, duke respektuar integritetin akademik. Këto procese janë të strukturuar për të shmangur çdo lloj diskriminimi ose pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Dokumentacioni dhe praktikat e vlerësimit janë të qarta dhe transparente, duke garantuar një trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë përfshirësit në proces. <i>(Evidence 6. Rregullore e programit Bachelor ne Teknik ne Radiologji Mjekesore Imazheri dhe Radioterapi)</i> <i>(Evidence 57 - Rregullore e NjSBC)</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësinë të takojë me aktorë kyç të jetës akademike, përfshirë Dekanin e Fakultetit, Përgjegjësin e Departamentit, përfaqësues të stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe me grupin e vetëvlerësimit, përfaqësues të NjSBC dhe Zyrës së Karrierës. Takimet konfirmuan një organizim të mirë të punës së përditshme, angazhim të plotë në procesin e akreditimit dhe një motivim të lartë për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Institucioni ka arritur të përfshijë bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm, të cilët janë të pranishëm në proceset e vlerësimit dhe kontribuojnë me ekspertizën e tyre, duke siguruar një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. Sipas dokumentacionit dhe Tabelave RVB, një anëtar/ekspert i jashtëm është pjesë e NJBSC, duke garantuar integritetin e palëve të jashtme në vlerësimin e programit të studimit dhe proceset e sigurimit të cilësisë. <i>(Evidence 92. Tabelat permbljedhese per Aneks_RVB - Ba. Teknik ne Radiologji mjekesore Imazheri dhe Radioterapi)</i> <i>(Vizita ne Institucion)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni ka arritur të krijojë një proces të strukturuar dhe të efektshëm për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në proceset e vlerësimit. Pjesëmarrja aktive e stafit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm garanton një proces të drejtpërdrejtë dhe të integruar të vlerësimit, duke respektuar gjithashtu integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në	Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë është angazhuar në mënyrë aktive për trajtimin dhe zgjidhjen e sfidave që lindin gjatë

kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	mësimdhënies dhe auditimeve të ndryshme në strukturë. Institucioni respekton plotësisht lirinë akademike dhe etikën, si dhe garanton përputhshmërinë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë janë miratuar formalisht, të dokumentuara dhe rishikuar rregullisht për t'iu përgjigjur ndryshimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm. <i>(Evidence 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD)</i> <i>(Evidence 57 - Rregullore e NJSBC)</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me fakultetet, organizon seanca informuese për studentët në lidhje me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit të pedagogëve dhe ndikimin e këtyre rezultateve në përmirësimin e programit të studimit. Institucioni siguron transparencë në publikimin e këtyre rezultateve, duke respektuar plotësisht lirinë akademike, etikën dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>(Evidence 57 - Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Evidence 59. Formular NJSBC - Vlerësim i studentit per pedagogun)</i> <i>(Evidence 61. Pyetesor i NJSBC qe plotesoret nga studenti per aktivitetin në IAL)</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni harton dhe implementon një plan masash për të adresuar mangësitë dhe dobësitë e evidentuara gjatë procesit të vlerësimit. Ky plan masash është i bazuar në rezultatet e vlerësimeve dhe synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, duke përfshirë ndërhyrje të nevojshme në aspektet e mësimdhënies, kurrikulës dhe mbështetjes për studentët. Plan masash siguron gjithashtu monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve të ndërmarra. <i>(Evidence 56. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024)</i> <i>(Evidence 57 - Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Evidence 58. Plan vjetor i aktiviteteve te NJSBC - viti akademik 2023-2024)</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni siguron që monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë të kenë ndikim të matshëm në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Kjo arrihet përmes analizës të rezultateve të vlerësimeve dhe implementimit të masave korrigjuese, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmbushjen e standardeve akademike. Institucioni ndjek me rigorozitet efektivitetin e këtyre veprimtarive, duke siguruar që përmirësimet të jenë të qëndrueshme dhe të dokumentuara për të garantuar progresin e vazhdueshëm. <i>(Evidence 56. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024)</i>

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në përgjithësi, rezultatet e këtyre aktiviteteve kanë evidentuar disa problematika, por ato kanë qenë të natyrës jo madhore dhe nuk kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në procesin akademik. Kjo tregon angazhimin e institucionit për të përmirësuar cilësinë dhe për të siguruar një mjedis të favorshëm mësimor. <i>(Evidence 56. Raport vjetor i sigurimit te cilesise- NJSBC - 2023-2024)</i> <i>(Evidence 65. Raporti vjetor)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka krijuar mekanizma efektive për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, duke angazhuar personelin dhe studentët në veprimtari periodike informimi dhe ndërgjegjësimi.</i> <i>Institucioni ka treguar angazhim të vazhdueshëm për rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e mëtejshëm të performancës akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Kolegji Universitar REALD"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit përputhet me profilin dhe fushën e veprimtarisë së institucionit duke qënë në mbështetje të interesave të rajonit për të diplomuar në *Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi*.

Pika të dobta:

1. Numri i ulët i personelit akademik për kategorinë Profesor ndikon drejtpërdrejt në ofrimin e një mbështetjeje të mjaftueshme akademike dhe në zhvillimin e një mjedisi të pasur mësimor.
2. Mungesa e infrastrukturës laboratorike pengon shfrytëzimin e praktikave mësimore efikase, duke e vështirësuar aplikimin e njohurive teorike në përputhje me natyrën e programeve të studimit.
3. Angazhimi i personelit akademik me MSc. si titullar lënde, në kundërshtim me aktet rregullatore në fuqi, ul nivelin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkesave akademike.
4. Mungesa e përditësimit të syllabuseve me literaturë të pesë viteve të fundit kufizon mundësitë për ofrimin e informacionit të përditësuar dhe relevant për studentët, duke penguar përgatitjen e tyre në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e studimit.

Rekomandime:

1. Rritja e numrit të personelit akademik për kategorinë Profesor është e nevojshme për të siguruar mbështetje akademike të mjaftueshme dhe për të zhvilluar një mjedis mësimor më të pasur dhe më efikas.
2. Investimi në infrastrukturën laboratorike është thelbësor për të mundësuar shfrytëzimin e praktikave mësimore efikase, duke u mundësuar studentëve aplikimin e njohurive teorike në përputhje me natyrën e programit të studimit.
3. Respektimi i akteve rregullatore dhe angazhimi i personelit akademik me tituj përkatës është i domosdoshëm për të garantuar cilësinë e mësimdhënies dhe përmbushjen e kërkesave akademike të programit.
4. Përditësimi i syllabuseve me literaturën më të fundit është i nevojshëm për të siguruar që studentët të kenë informacion të përditësuar, duke i përgatitur ata në mënyrë të duhur për zhvillimet më të fundit në fushën e studimit.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Technician in Medical Radiology, Imaging and Radiotherapy" provided by the Higher Education Institution "REALD"

Strengths and affirmations

1. The study program is consistent with the profile and field of activity of the institution, supporting the interests of the region to graduate in *Technician in Medical Radiology, Imaging and Radiotherapy*.




Weaknesses

1. The low number of academic personnel in the Professor category directly impacts providing adequate academic support and developing a rich learning environment.
2. The lack of laboratory infrastructure impedes the effective implementation of practical teaching methods, limiting the ability to apply theoretical knowledge in alignment with the objectives of the study programs.
3. The engagement of academic personnel with an MSc degree as course leaders, in contradiction with the applicable regulatory frameworks, lowers the quality of teaching and the fulfillment of academic requirements.
4. The absence of updates to syllabi with literature from the past five years limits the opportunities to provide up-to-date and relevant information to students, hindering their preparation in line with the latest developments in the field of study.

Recommendation

1. The increase in the number of academic personnel in the Professor category is necessary to ensure adequate academic support and to foster the development of a richer and more efficient learning environment.
2. Investment in laboratory infrastructure is essential to enable the effective use of practical teaching methods, allowing students to apply theoretical knowledge in alignment with the nature of the study programs.
3. Adherence to regulatory frameworks and the engagement of academic personnel with appropriate qualifications are essential to guarantee the quality of teaching and the fulfillment of academic requirements of the program.
4. The updating of syllabi with the latest literature is necessary to ensure that students have access to up-to-date information, adequately preparing them for the latest developments in their field of study.



62

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

